



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Psikologji e Përgjithshme ”**

**Universiteti Privat “Albanian University”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr Eralda ZHILLA**

**Dr Skerdi ZHAJ**

**Prill / 2021**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bsc në “Psikologji e Përgjithshme”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në “Psikologji e Përgjithshme”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 8981. Prot, datë 27.12.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 509, datë 13.10.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 84, datë 21.09.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	32 studentë (për një cikël të plotë studimi)
19	Komente / të tjera:	-

*BR* *ELW*

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Privat "Albanian University", është institucion jopublik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin Nr. 197, datë 10.04.2004 të Këshillit të Ministrave, dhe zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Sipas strukturës dhe Statutit të AU, të miratuara në vitin 2016, aktualisht ky universitet përbëhet nga tre fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në "Psikologji e Përgjithshme" licensuar me Shkresë MASH Nr. 8981. Prot, datë 27.12.2005.


Programi është akredituar për herë të parë, me UMASH Nr. 541, datë 01.12.2010. Akreditimi periodik i programit, është bërë me VBA Nr. 84, datë 21.09.2017. Kohëzgjatja e këtij akreditimi është 3 vite, me afat 30.09.2020.

Programi Bachelor në "Psikologji e Përgjithshme", ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, i cili është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Ky program studimi është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.

"Albanian University" e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", me Statutin dhe Rregulloren e tij si dhe në aktet rregullatore për aspekte specifike të Universitetit.

Programi i studimit "Bachelor në Psikologji e Përgjithshme" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme. Programi është i organizuar në 6 semestra, ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe numër total kreditesh 180.

Misioni i programit të studimit është të ofrojë arsim dhe trajnim të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës profesional për aplikimin e teorive, dijeve, aftësive dhe kompetencave psikologjike në institucionet publike dhe private, të cilat e kanë themelore praninë e psikologut. Objektivat e këtij programi studimi përfshijnë përgatitjen e një brezi të ri profesionistësh të psikologjisë të aftë për të kuptuar dhe trajtuar me profesionalizëm, etikë dhe në respekt të dinjitetit dhe integritetit njerëzor, problematikat psiko-sociale me të cilat ndeshen individët dhe shoqëria shqiptare. Përgatitja e psikologëve të përgjithshëm të cilët të mund të vazhdojnë studime të mëtejshme në një gamë të gjerë të nëndisiplinave të psikologjisë. Kjo përgatitje, paralelisht me politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve, do të lehtësojë edhe futjen e studentëve të diplomuar në këtë program studimi në tregun e punës.



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 84, datë 21.09.2017 janë:

1. Institucioni duhet të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik me kohë të plotë;
2. Të rekrutohet staf i ri akademik me kohë të plotë e të pjesshme, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të stafit të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi, për të mundësuar angazhimin e stafit aktual edhe në punë kërkimore shkencore;
3. Të ngrihet pranë Departamentit të Psikologjisë një zyrë e Këshillimit Psikologjik për realizimin e praktikave profesionale të studentëve;
4. Të sigurohen tekste mësimore në fushën e psikologjisë, me qëllim mbulimin e të gjithave lëndëve me literaturën përkatëse;

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Në takimet e zhvilluara në institucion si dhe bazuar në dokumentat e dorëzuara, GVJ konstaton që institucioni është përpjekur të përmbushë një nga rekomandimet më të rëndësishme të dhëna nga akreditimi i mëparshëm, por ka ende nevojë për përmirësim. Megjithëse, gjatë tri viteve të fundit (2017-2020), ngarkesa mësimore e stafit akademik është shpërndarë sipas udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi dhe stafi akademik me kohë të plotë mbulon rreth 78 % të orëve mësimore në auditor si edhe ka kualifikimet e nevojshme si “Profesor i Asociuar” apo “Doktor i shkencave, ne si GVJ konstatuam që ka ende nevojë për përmirësim. Në këtë departament vijon që të këtë lëvizje e stafit të brendshëm dhe të jashtëm. Në këtë pikë, vlen të theksohet që ka përmirësime por levizjet e stafit akademik janë një faktor që vihet re. Gjithashtu, një pjesë e vogël e pedagogëve nuk i përkasin profilit psikologjik me të paktën 2 cikle studimi në fushë dhe japin mësim lëndë profesionale aplikative. Për këtë arsye GVJ rekomandon shtimin e pedagogëve brenda fushës së psikologjisë dhe ndarjen e tyre sipas disiplinave përkatëse. Secili pedagog të japë ato lëndë që i përkasin specialitetit të tij dhe ushtrimit të praktikës së tij profesionale dhe jo jashtë fushe. Megjithëse në kuadër të garantimit të qëndrueshmërisë së stafit akademik, Zyra e burimeve njerëzore, AU në bashkëpunim me zyrën juridike kanë rishikuar përmbajtjen e kontratave të punës së stafit akademik me kohë të plotë (PAE) si dhe me Kontratë (PAK) në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 si dhe Kodin e Punës, në RSH. Ne si GVJ sugjerojmë që institucioni duhet të ndërmarë hapa të tjerë në përmirësimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. **GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur kryesisht**

2. Siç është cituar edhe më sipër, institucioni ka bërë përpjekje lidhur me rekrutimin e stafit me kohë të plotë dhe të pjesshme, por ka ende nevojë për t’u përmirësuar në këtë drejtim. GVJ rekomandon rekrutimin e stafit brenda profilit përkatës dhe në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë përsa i përket gradave dhe kualifikimeve. Ende nuk është bërë një ndarje lidhur me angazhimin e stafit për kërkimin shkencor dhe mësimdhënien.

**GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

3. Nga shqyrtimi dokumentacionit, raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka marrë masa për ngritjen e zyrës së Këshillimit Psikologjik, si dhe ka miratuar Udhëzuesin dhe planin e punës në funksion të shërbimit “Këshillim Psikologjik”, duke i ardhur në ndihmë kërkesave dhe nevojave mësimore dhe psikologjike të studentëve. ( *Evidencë nr. R3*). Kjo zyrë nuk është konceptuar si një strukturë e vetme por e atashuar pranë departamentit. Pedagogët kanë suportuar studentët në lidhje me nevojat që ata kanë patur, por nuk ka patur persona përgjegjës në këtë drejtim. GVJ konstaton që kjo strukturë e atashuar tashmë pranë departamentit ka nisur punën kryesisht së fundmi dhe ka shërbyer më shumë si orientim dhe këshillim karriere për studentët, jo në fokusin e saj primar për të cilën është ngritur bazuar në rekomandim. Pra GVJ thekson që institucioni ka përmbushur deri diku rekomandimin që është dhënë nga akreditimi i mëparshëm, por nuk ka qenë shumë aplikative dhe në përputhje me nevojat e studentëve në fushën e psikologjisë. Gjithashtu ky grup rekomandon që kjo zyrë të vazhdojë punën e saj me trajnime për student dhe pjesëmarrës së jashtëm, por nuk i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për të ofruar shërbim klinik dhe këshillim psikologjik. Pra zyra (klinika) duhet të ndryshojë fokusin e punës së saj. Ajo mund të atashohet pranë zyrës së karrierës nëse nuk ka një hapësirë tjetër, jo pranë departamentit sic ka operuar deri tani, pasi krijon mbivendosje.

**GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

4. Për rekomandimin lidhur me përmirësimin e bibliotekës, institucioni ka bërë përpjekje për të përmirësuar situatën, duke përmirësuar kushtet fizike të bibliotekës si dhe me ofrimin e një librerie online. Biblioteka online është në dispozicion të stafit dhe studentëve. Në bibliotekën e godinës qendrore janë rreth 172 tituj të disponueshëm për pedagogët dhe studentët, të cilët janë në ndihmë të programeve të studimit që ofron departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme. Në funksion të programit të studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” është libraria on line “QUESTIA” e cila ka rreth 83,000 libra akademike dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë të cilët u vijnë në ndihmë studentëve si literaturë ndihmëse dhe për të realizuar detyrat e kursit e punimet kërkimore. Gjithashtu, biblioteka, ndërmarrja botuese Albanian University Press, revista e universitetit “Optime” kanë botime periodike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore. Nga vizita në institucion si dhe kontrollet online, GVJ konstatoi që kjo bibliotekë ishte aktive dhe u ofronte studentëve mundësi për të shfletuar libra, artikuj të fundit të fushës së psikologjisë.

**GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” të ofruar nga Departamenti i Psikologjisë Përgjithshme, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga AU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Dr. Eralda Zhilla dhe Dr. Skerdi Zahaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Periodik (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme”, ofruar nga “Albanian University”. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet nga intervistat dhe vëzhgimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, ne si Grup i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), jemi përpjekur që të jemi sa më objektiv dhe të paanshëm dhe të vlerësojmë në mënyrë sa më të plotë të gjithë programin. Gjithë procesi i vlerësimit ka ndodhur në një atmosferë shumë mikëpritëse dhe profesionale nga “Albanian University” dhe nga kolegët dhe studentët e Departamentit të Psikologjisë.

Gjatë shkrimit të këtij Raporti, ne si Grup i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) kemi punuar së bashku dhe kemi rënë dakord si për vlerësimin tërësor të programit ashtu edhe në vlerësimin specifik të standardeve të caktuara.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.03.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 11/5 Prot, datë 29.03.2021. Universiteti Privat “Albanian University” përcjell në ASCAL më datë 01 Prill, me anë të shkresës me Nr. 165/1 Prot, datë 01.04.2021 “Përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Psikologji e Përgjithshme”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi është hartuar në duke u mbështetur në planin strategjik institucional ( <i>evidencë I.1</i> ) dhe me misionin e institucionit. Programet e studimit të ofruara nga Referuar RVB-së, programi i studimit është në përputhje të plotë me vlerat akademike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë dhe të kombit shqiptar, në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në “Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë”. Programi i studimit u siguron studentëve aftësi akademike dhe etike të nevojshme që mund t’i ndihmojë ata të jenë në gjendje të kontribuojnë në mjedisin kërkimor në Shqipëri dhe në zhvillimin e tyre profesional.  Albanian University of Education ofri programe studime të cilat janë në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” synon që të formojë profesionistë të kualifikuar në fushën e psikologjisë si edhe të rrisë vetëdijen qytetare dhe morale tek studentët duke reflektuar vlerat më të larta morale dhe etike në shërbim të grupeve vulnerablë në veçanti dhe shoqërisë Shqiptare në tërësi. Për më shumë mund të shikohet <i>evidencë I.3 (I.3. Plani strategjik i departamentit)</i> dhe <i>evidencë I.5 (I.5 Rregullore e Bsc ne Psikologji e Pergjithshme)</i> .
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit institucional si, ( <i>Evidencë I.4 Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15</i> ), dhe ( <i>I.3.Plani strategjik i departamentit</i> ), GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit si edhe me fushën e zhvillimit të psikologjisë.  Referuar ( <i>I.5 Rregullore e Bsc ne Psikologji e Pergjithshme</i> ). Programi i studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” ka objektiva të qartë përsa i përket zhvillimit të aftësive dhe formimit të përgjithshëm të lidhura me sjelljen etike dhe profesionale dhe synon të hedhë bazat për zhvillim profesional të mëtejshëm në nivel master të studentëve. Ky program studimi ka si qëllim të formojë psikologë

	të përgjithshëm, dhe të ndikojë si në aftësimin e tyre profesional ashtu edhe në atë njerëzor.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Referuar kushteve aktuale të pandemisë nga Covid 19, Psikologjisë dhe miratimit të Ligjit për Urdhrin e Psikologut (UP) në Republikën e Shqipërisë 40/2016 mund të argumentohet tregu ka ende nevojë për psikologë. Duke qenë se profesioni i psikologut është në listen e profesioneve të rregulluara mund të argumentojmë se ende ka nevojë për përfshirjen e psikologut në shërbimet publike dhe private në vend. Në këtë perspektivë programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Referuar studimit dhe analizës së tregut të punës ( <i>Evidencë I.6. Analiza e tregut të punës</i> ) të zhvilluar nga institucioni, megjithëse ka një rënie e kërkesës për të vijuar studimet në psikologji, Albanian University është ndër institucionët që ofron një program bashkëkohor dhe ende ka kërkesë. Për të plotësuar nevojat e tregut, programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” ofron lëndë mësimore që ndikojnë në formimin e përgjithshëm të studentëve dhe duke krijuar rrugën që në të ardhmen, pas studimeve master, këta studentë të jenë një vlerë e shtuar në sektorët social dhe ekonomik të vendit. Megjithatë duhet të theksojmë se programet studimore që diplomojnë studentët në fushat sociale kanë në fokus më shumë zhvillimin dhe mirëqënien sociale të vendit dhe më pak në fokus zhvillimin ekonomik të tij.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ konstaton se programi i Studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” është pjesë e strategjisë së zhvillimit të institucionit. Në bazë të vezhgimeve të dokumentacionit përkatës dhe intervistave me stafin, planet vjetore dhe strategjike të zhvillimit ( <i>Evidencë nr. I.1</i> ), ( <i>Evidencë nr. I.2</i> ) dhe ( <i>Evidencë nr. I.3</i> ) “Albanian University” e ka të përcaktuar qartë përshtatjen dhe zbatimin e strategjisë për zhvillim e Departamentit dhe të Programit “Psikologji e Përgjithshme”. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme i ka orientuar veprimtarinë e tij duke ofruar mësimdhënie edhe me një numër të vogël studentësh, duke punësuar staf akademik të dedikuar ndaj tyre, në kërkim shkencor, si edhe ndërtimin e marrëdhënieve me organizata



	vendase dhe të huaja, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, kryerjen e projekteve/detyrave të kursit, studime kërkimi.			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ konstaton se statuti ( <i>Evidencë I.4 Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15</i> ) dhe rregullorja e programit ( <i>Evidencë I.5 Rregullore e Bsc ne Psikologji e Pergjithshme</i> ) përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. Gjithashtu, plani strategjik institucional 2017-2022 ( <i>Evidence I.1 Plani strategjik institucional 2017-2022</i> ) dhe plani strategjik i departamentit ( <i>Evidence I.3 Plani strategjik i departamentit</i> ) kanë si prioritet të qënin një institucioni inovativ që të nxis mësimdhëniën cilësore dhe kërkimin shkencor në të gjitha fushat si edhe në ndikimin e formimit të njeriut. Nuk vihet re asnjë lloj mospërputhje midis statutit, rregulloreve dhe mënyrës sesi është hartuar dhe ofruar programi i studimit në psikologji të përgjithshme.			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Universiteti Privat “Albanian University” përbëhet nga tre njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;</li> <li>2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;</li> <li>3. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;</li> </ol> <p>Programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Për mbarëvajtjen e zbatimit të programit përgjigjen Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. GVJ nga shqyrtimi i rregullores së programit dhe i syllabuseve të lëndëve, sugjeron se programi kryesisht synon dhe thekson formimin e përgjithshëm bazë mbështetur në metoda dhe parime shkencore dhe bashkëkohore. GVJ konstaton se ky program studimi është hartuar në përputhje me fushat akademike që mbulon Albanian University. Për më shumë mund të shikohen (<i>Evidencë I.4 Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80 -15</i>), (<i>I.3.Plani strategjik i departamentit</i>) dhe evidencë I.5 (<i>I.5 Rregullore e Bsc ne Psikologji e Pergjithshme</i>).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve dhe synon që të përgatisë psikologë me njohuri të plota dhe bashkëkohore në fushën e psikologjisë.</p> <p>Sipas Rregullores së Programit të Studimi të Ciklit të parë "Bachelor" në "Psikologji e Përgjithshme" neni 4, ky program synon që të zhvillojë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale tek studentët. Gjithashtu, siç e theksuan pedagogët edhe studentët gjate intervistave, ata pajisen me të gjitha këto elementë si edhe me aplikimin praktik të disa nga këto aftësitë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në rregulloren e programit objektivat e studimit të marrin një hapësirë më të madhe.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi se Albanian University ka zhvilluar studim për tregun lokal përpara hapjes së programit si edhe kryen studime periodike pas daljes së studentëve (<i>Evidencë I.6. Analiza e tregut të punës</i>).</p> <p>Megjithëse studimet kanë limite metodologjike ato janë ndihmuese për të orientuar kërkesat dhe mundësitë punësimit dhe zhvillimet aktuale në sektorin psikologjik. Por, më shumë këto studime mund të ndihmojnë në orientimin për hapjen e masterave në psikologji pasi psikologët mund të ushtrojnë profesionin e tyre vetëm pasi përfundojnë studimet master profesional ose shkencor sipas Ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”. Si pjesë e studimit tregut të punës, Departamenti i Psikologjisë ka vendosur kontakte me shumë institucione publike dhe organizata që studentët mund të zhvillojnë praktikat.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” e Albanian University siguron studentët në përfitimin e dijeve dhe aftësive dhe i përgatit ata për vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë në psikologji.</p> <p>Sipas Rregullores së Programit të Studimi të Ciklit të parë "Bachelor" në "Psikologji e Përgjithshme" neni 4, ky program synon që të zhvillojë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale tek studentët. Programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” siguron një formim të përgjithshëm dhe lehtëson zhvillimin e shkathtësive më komplekse në studimet Master në mënyrë që studentët t’ju përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë procesin e punësimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që përmbajtja e programit mund të përmirësohet deri në nivelin 20% për vitin akademik pasardhës sidomos në disa lëndë shume specifike dhe të avancuara për</i></p>

	<i>programin e ciklit të parë dhe disa lëndë me zgjedhje që nuk janë zhvilluar dhe përzgjedhur nga studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi I.4

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore është një nga Njësitë kryesore që e ka filluar veprimtarinë e vet me hapjen e këtij institucioni në vitin akademik 2005-2006. Fakulteti ka krijuar profilin e tij dhe është konsoliduar gradualisht për t'iu përgjigjur zhvillime kombëtare. Fakulteti i Shkencave Shoqërore për vitin akademik 2019-2020 ka gjithsej <b>107 pedagogë</b>, nga të cilët <b>38 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 23 kanë gradën Dr., dhe 11 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>69 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 7 kanë titullin “Profesor”, 11 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 30 kanë gradën Dr. dhe 21 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka 10PAE dhe 23 PAK.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës (<i>RVB Bsc. Psikologji e Përgjithshme dhe tabelat vulosur., tabela nr.6.3</i>), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie <b>21 pedagogë gjithsej</b>, ku <b>8 PAE</b>, nga të cilët 1 Prof.Asoc, 3 me gradën Dr, si edhe 4 asistente-lektore me Msc, dhe <b>13 PAK</b> nga të cilët 1 Prof.Asoc, 7 me gradën Dr, si edhe 5 asistente-lektore me Msc.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2019-2020 rezultoi 38% me 62%.</p> <p>Ndërsa për vitin akademik 2020-2021 referuar evidencës (<i>Stafi 20-21 per program studimi.pdf</i>), të kërkuar gjatë vizitës në institucion, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie <b>16 pedagogë gjithsej</b>, ku <b>11 PAE</b>, nga të cilët 1 Prof.As, 7 me gradën Dr dhe 3 asistentë lektorë me Msc, dhe <b>5 PAK</b> nga të cilët 1 Prof.As, 1 me gradën Dr dhe 3 asistentë lektorë me Msc.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezultoi 68% me 32%.</p>

	Referuar shqyrtimit të CV –ve të stafit akademik, GVJ konstatoi se një pjesë e personelit akademik nuk i ka studimet bazë në fushën e psikologjisë por vetëm studimet e ciklit të dytë dhe/ose të tretë. Gjithashtu, GVJ konstatoi se disa lëndë me karakter profesional dhe aplikativ në fushën e psikologjisë nuk përputhen plotësisht me formimin e pedagogëve që janë autor të parë të tyre. <i>GVJ rekomandon që Albanian University të përpiqet që në punësimet e reja të stafit akademik të kujdeset që ata të kenë studime vijimisht në psikologji dhe të rishikojë sidomos pedagogët që japin mesim lëndët profesionale me karakter aplikativ.</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore referuar rregullores së departamentit të psikologjisë dhe strukturës së Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Shoqërore reflektuar kjo në objektivat dhe në programin e studimit.  Gjithashtu, GVJ konstatoi se programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të departamentit të psikologjisë. Në total, departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ofron 4 programe studimi në të dy nivelet, një program studimi në ciklin e parë dhe tre programe studimi në ciklin e dytë. Të gjitha programet e studimit janë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe me Urdhrin e Psikologut si enti rregullator i këtij profesioni.			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe	GVJ konstatoi se Albanian University për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit “Bachelor” në “Psikologji e

<p>mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Përgjithëshme” siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda të gjithë institucionit i cili është i organizuar në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, në mënyrë që të përmbushë misionin e tij. Njësitë bazë organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore dhe njësitë kryesore koordinojnë aktivitetet e njësive bazë që ata përfaqësojnë. Gjithashtu, GVJ konstatoi se Albanian University zhvillon analizën e vazhdueshme të punës së strukturave përmes një sërë treguesve të matshëm të realizimit të detyrave në formën e raportimeve tek drejtuesit e Departamentit ose Dekanit, nëpërmjet takimeve periodike me titullarët, si dhe një rol kyç ka edhe vlerësimi i performancës së pedagogut. Ne si GVJ, vumë re se Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme bashkëpunon me departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore për shkëmbimin e pedagogëve, të mësimdhënies, të kërkimit shkencor si dhe aktivitete të tjera ekstrakurrikulare.</p> <p>Kjo është një vlerë e shtuar e institucioneve të vogla por në të njëjtën kohë mund të raportohen aktivitete që nuk janë të dedikuara vetëm për Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme dhe/ose vetëm për këta student. Do të ishte mirë që aktivitetet e dedikuara për një departament të diferencohen dhe të dalin më shume në pah.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstatoi se Albanian University për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi të shumta kërkon bashkëpunime të reja që kontribuojnë në rritjen akademike të institucionit dhe zhvillimin e profesionalizmit të stafit pedagogjik. Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ vëzhgoi të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit që mund të shërbejnë për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve. Më konkretisht, marrëveshjet e bashkëpunimit me disa universitete brenda vendit janë si Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universiteti i Tiranës, etj, disa universitete dhe kolegje universitare në Kosovë, Itali, Turqi, Austri etj. Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit është dhënë në aneks (<i>Evidencë I.7</i>). Gjithashtu, shumë marrëveshje që plotësohen nga koordinatori i programit ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë. Të gjitha këto mund të konfirmohen në (<i>Evidencë nr.I.8</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se, ashtu siç paraqitet në tabelën përmbledhëse për marrëveshjet me institucionet bashkëpunuese dhe nga intervistat me personelin akademik dhe studentët, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh. Kjo u raportua edhe nga pedagogët edhe nga studentët. Sipas rregullores së Departamentit cdo pedagog koordinon praktikën profesionale dhe ruan marrëdhëniet me supervisorin e studentit. Departamenti e vlerësoi si një nga pikat e forta këtë pike, por raportuan që pandemia Covid -19 e ka ndikuar ndjeshëm në</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ konstatoi se, ashtu siç paraqitet në tabelën përmbledhëse për marrëveshjet me institucionet bashkëpunuese dhe nga intervistat me personelin akademik dhe studentët, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh. Kjo u raportua edhe nga pedagogët edhe nga studentët. Sipas rregullores së Departamentit cdo pedagog koordinon praktikën profesionale dhe ruan marrëdhëniet me supervisorin e studentit. Departamenti e vlerësoi si një nga pikat e forta këtë pike, por raportuan që pandemia Covid -19 e ka ndikuar ndjeshëm në</p>

	mungesën e zhvillimit të praktikave si edhe në gjetjen e mundësive të reja.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GVJ konstatoi se institucioni nuk ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Gjithësesi ne si GVJ do të sugjerim që Departamenti mund të aplikojë për trajnime të edukimit në vazhdim. Gjithashtu mund të zhvillojnë trajnime që t'i përgatisin studentët për karrierën e tyre në të ardhmen.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

### Standardi II.1

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” është hartuar dhe licensuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).  Lëndët dhe modulet realizohen brenda 3 viteve të studimi dhe brenda 6 semestrave. Në përfundim të studimeve studentët marrin 180 ECTS në total. Gjithashtu, lëndët dhe modulet janë të ndara sipas veprimtarisë formuese nga A në E.  Të gjitha këto paraqiten në planin mësimor të Programit të Ciklit të Parë ”Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme”
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	GVJ pasi shqyrtoi ( <i>Evidencë nr. II.1.Plani mesimor.pdf</i> ) dhe referuar takimeve me drejtuesit dhe stafin akademik konstatoi se programi i studimi të ciklit të parë në “Psikologji e Përgjithshme” ka për qëllim: të përgatis studentë me njohuri të thelluara teorike, praktike dhe shkencore në fushën e psikologjisë, si dhe me kompetenca për

	<p>studime të mëtejshme, specializime apo trajnime në këtë fushë. Programi i studimi të ciklit të parë në “Psikologj e Përgjithshme” i prezanton studentët me një sërë specialitetesh si atë të psikologut klinik, këshillimit, shkollor dhe organizacional. Duke marrë në konsideratë numrin e vogël të studentëve ofrohet një mjedis i afërt dhe profesional, ku studenët mbështeten individualisht nga pedagogët për zhvillimin e tyre profesional.</p> <p><i>GVJ rekomandon shqyrtimin e disa programeve të lëndëve deri në masën 20% dhe sidomos disa lëndë specifike si ato me zgjedhje të cilat nuk janë zhvilluar dhe nuk preferohen nga studentët nuk kanë pse të jenë pjesë e programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” i pajis studentët me njohuritë dhe aftësitë e duhura bazë në fushën e psikologjisë. Ky program iu mundëson atyre që të konkurojnë në specializime brenda vendit ose jashtë vendit në mënyrë që të vijojnë studimet e tyre dhe të përballen me kërkesat në rritje të tregut të punës. Gjithashtu ky program mbështetet në objektiva të qarta dhe të arritshme me synim kualifikimin e nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe përpiqet që ti prezantojë me të rejtat shkencore të fushës së psikologjisë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” synon që të diplomuarit të kenë një formim psikologjik, shkencor dhe profesional në nivelet e kërkuara nga një program i ciklit të parë. Programi ndihmon studentët që të marrin njohuri dhe të zhvillojnë kompetenca bazike në një sërë disiplinash të psikologjisë dhe të nxisin motivimin për të vijuar specializimet më pas në nivelin Master. Gjithashtu, programi ofron mundësi që studentët të ndërmarrin praktika në subjekte publike dhe private. Praktika i ndihmon studentët të njohin më nga afër aplikimin e psikologjisë në fusha të ndryshme. Falë numrit të vogël të studentëve ofrohet një mjedis mbështetës ku studentët, për zhvillimin e tyre akademik dhe personal, mbështeten individualisht nga pedagogët.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të planit mësimor dhe syllabuseve konstatoi se elementet që përbëjnë strukturën e programit bazohen mbi përcaktimet e VKM 41, datë 24.01.2018 dhe analizohen më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- programi është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, ku çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS me një total prej 180 ECTS;</li> <li>- Plani mësimor konstatohet se ka të përcaktuara dhe të deklaruara objektivat formuese që synohet të arrihen si dhe kompetencat profesionale që synohet të fitojnë studentët në përmbyllje të studimeve të tyre;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtareve formuese nga A-E. Veprimtaritë formuese të tij janë të përcaktuara dhe GVJ konstaton se: <ul style="list-style-type: none"> <li>o lëndët bazë (kategoria A) kanë 33 ECTS ose 18.3% të krediteve,</li> <li>o lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 98 ECTS, ose 54.4 % të krediteve,</li> <li>o lëndët integruese (kategoria C) kanë 25 ECTS, ose 13.8 % të krediteve,</li> <li>o lëndët plotësuese (kategoria D) kanë 18 ECTS, ose 10 % të krediteve,</li> <li>o kategoria E e detyrimeve përmbyllëse përmban 6 kredite ose 3.3% të krediteve të PS;</li> </ul> </li> <li>- GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2). Ato janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion/seminar;</li> <li>- Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës.</li> </ul>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi Programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” konstatoi se Albanian University i ka përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Gjithashtu, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse miraton dhe organizon modulet / lëndët të vlerësuara me kredite përgjegjëse të ndara në vite dhe semestra në përputhje me planin mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për çdo lëndë/modul përcaktohen ngarkesa përkatëse në kredite; format e ndryshme të mësimdhënies; ngarkesa në auditor dhe jashtë tij dhe kategoria të cilës i përket (<i>Evidencë II.1</i>). Gjithashtu, programi përmban syllabuset sipas formatit të miratuar.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="background-color: #cccccc;">Nuk përmbushet</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e	GVJ konstatoi se Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin pasi

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>bashkërendon dhe administron veprimtaritë akademike, veprimtaritë kërkimore shkencore në respekt të lirisë akademike të stafit mësimdhënës. GVJ referuar informacionit në systemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Universiteti Privat Albanian University ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 01, datë 24.01.2020, të Bordit të Akreditimit me kohëzgjatje tre vite akademike.</p> <p>Numri total i stafit efektiv të Departamentit për vitin akademik 2019-2020 është <b>10 pedagogë gjithsej</b>, nga ku 1 është Prof.Asoc., 5 Dr., 3 janë Dr. proc dhe 1 është Msc Gjithashtu, departamenti ka edhe 23 pedagogë më kohë të pjeshme.</p> <p><i>GVJ vlerësoi faktin së 6 anëtarë me kohë të plotë përmbushin detyrimin me tituj dhe gradë shkencore por rekomandojmë që stafi të shtohet me pedagogë që kanë formim bazë në psikologji si një vlerë e shtuar për programin e studimit.</i></p> <p>Sipas planit të punës për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm, departamenti është njësi bazë që përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin dhe njësi bazë propozon grupin e vlerësimit të brendshëm, organizon punën nëpërmjet një plan pune për programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>GVJ mbështetur në informacionin e depozituar në DVV konstatoi se njësia kryesore ka përcaktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme”, ku janë të miratuara, edhe janë të përcaktuara të gjitha detyrat në përputhje me objektivat e programit. Koordinator i programit të studimit (<i>paraqitur në evidencën nr. I.8</i>) është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit (<i>Evidencë nr. I.5</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti i “Psikologjisë së Përgjithshme” është njësia bazë e zhvillimit të veprimtarisë mësimore dhe shkencore dhe gjithashtu është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrate. Sipas statutit të Albanian University dhe RVB ky Fakultet ka në përbërje katër departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;</li> <li>2. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative;</li> <li>3. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes;</li> <li>4. Departamenti i Shkencave Juridike;</li> </ol>

	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme plotëson të gjitha kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin akademik dhe strukturor të specifikuar. Sipas rregullores së Departamentit të Psikologjisë së Përgjithashme njësia bazë mblidhet të paktën një herë në muaj dhe kryen një sërë funksionesh, përmbush kërkesat dhe standardet e cilësisë për organizimin e programit dhe përmbush nevojat kryesore për strukturën akademike, për stafin akademik dhe për kualifikimet e stafit akademik. Gjithashtu, sipas RVB personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ përbëhet nga:</p> <p>a) Kryesekretari i Sekretarisë Mësimore;</p> <p>b) Sekretarët e Sekretarisë Mësimore;</p> <p>c) Administrator FSHAE;</p> <p>d) Punonjës biblioteke FSHAE;</p> <p>e) Specialist IT;</p> <p>Personeli ndihmës - akademik me karakter mësimor:</p> <p>a) Asistentët e Departamenteve;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore në vitin akademik 2019-2020, ka në përbërje të tij <b>107 pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët, 38 janë staf akademik efektiv ( PAE), dhe 69 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2019-2020:</p> <p><b><u>Departamenti i Shkencave Juridike:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 9 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada;</li> <li>- 20 PAK, ndër të cilët, 11 me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;</li> <li>- 23 PAK, ndër të cilët 16 me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 12 PAE, ndër të cilët 10 me tituj / grada;</li> <li>- 13 PAK, ndër të cilët 10 me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Departamenti i Shkenca Politiko Administrative</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;</li> <li>- 13 PAK, ndër të cilët 9 me tituj / grada;</li> </ul> <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme që është përgjegjës për programin e studimit për dy vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (10 PAE/ 21 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 6/ 15;</p>

	<p>Për vitin akademik 2019-2020, (10 PAE/ 23 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 6/ 16;</p> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHSH) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik</li> <li>- organizimin dhe strukturën akademike.</li> </ul> <p><i>GVJ rekomandon që stafi të jetë stabil dhe të investohet në rritjen e tij si edhe të synohet përmirësimi i tij më formim bazë në psikologji sidomos për lëndët profesionale aplikative. Ky rekomandim është në të njëjtën linjë me rekomandimin e shkruar nga GVJ më përpara.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Bazuar në Rregulloren e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, përgjegjësitë dhe kompetencat e departamentit janë të përcaktuara në aktet dhe rregulloren e brendshme të Albanian University në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Albanian University.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se FSHSH dhe DPP, zotërojnë informacionin e plotë lidhur me programin e studimit Bsc në Psikologji e Përgjithshme, siç është plani mësimor, informacion mbi strukturën akademike, informacion mbi rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj. Këto informacione ju vendosën në dispozicion edhe GVJ.  <i>(II.1.Plani mesimor.pdf)</i> <i>(RVB Bsc. Psikologji e Pergjithshme dhe tabelat vulosur.pdf)</i> <i>(Stafi 20-21 per program studimi.pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar planit mësimor GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në ‘Psikologji e Përgjithshme’ është i organizuar në lëndë/module sipas Sistemit European të Transferimit dhe

<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ato realizohen në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se ky program është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 5 kategori, nga A deri tek E.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Referuar (<i>Evidencës II.1 dhe RVB</i>) ky program përbehet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lëndë bazë - (A) që plotësojnë 33 ETCS;</li> <li>- lëndë karakterizuese - (B) që plotësojnë 94 ETCS;</li> <li>- lëndë ndërdisiplinore/integruese - (C) plotësojnë 25 ETCS;</li> <li>- lëndë plotësuese - (D) plotësojnë 18 ECTS;</li> <li>- detyrime përmbyllëse - (E) që plotësojnë 6 ETCS;</li> </ul> <p>Programet e studimit të hartuara nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithëshme përmbajnë të gjitha informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor, mënyrat e vlerësimit të dijeve etj. Në planin mësimor paraqiten elementë si: kreditet për cdo veprimtari formuese, ngarkesa në auditor, periudha dhe mënyra e kontrollit të dijeve dhe modalitetet e tezës së provimit. (<i>Evidencë nr II.3</i>).</p> <p><i>GVJ rekomandon që programi i studimit të rishikohet në nivelin 20% me një fokus shumë të madh në lëndët me zgjedhje. Ky program mund të përmirësohet dhe të përshtatet me ndryshimet e reja në fushë si edhe me nevojat e studentëve.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në “Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimit të Studimeve” (<i>Evidencë nr.II.4</i>), GVJ konstatoi se “Departamenti i Psikologjisë së Përgjithëshme” i përmban të gjitha informacionet mbi transferimin, ekuivalentimin, dhe pranimin e studimeve. Fakulteti ka hartuar Rregulloren e Trasferimeve në të cilën janë të përcaktuara kriteret si ato të përgjithshme, ashtu dhe ato specifike për, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p>Në rregulloren e sipërcituar, paraqitet informacion i plotë për transferimet e studimeve nga IAL të tjera dhe transferimet brenda Universitetit, ku studenti duhet të ketë përfunduar të paktën një semestër në programin, ku është regjistruar që të ushtrojë të drejtën e transferimit në programe të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi syllabuset e programit të ciklit të parë “Bachelor në “Psikologji e Përgjithëshme” janë të organizuara në përputhje me formatet e miratuara. (<i>Evidencë nr.II.3</i>). Syllabuset përmbajnë informacion në lidhje me titullin e lëndës, objektivat e përgjithshëm/specifikë të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e leksioneve dhe seminarëve për çdo lëndë, kohëzgjatjen e zhvillimit të lëndës, formën e kontrollit të dijeve, nr e krediteve, bibliografinë dhe</p>

	emrat e pedagogëve përkatës. Gjithashtu, këto syllabuse në nivel departamenti janë të njëjta në të gjitha rubrikat e vlerësimit.			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë takimeve në institucion Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme raportoi se ndërmerr hapa të rëndësishme për rishikimin dhe përditësimin periodik të programeve të studimit bazuar në nevojat e tregut të punës dhe se kjo procedurë ndiqet me rigorozitet duke zbatuar me përpikmëri masën e lejuar mbi ndryshimet përkatëse në planin mësimor si dhe në zbatim të akteve nënligjore në fuqi, në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, <i>GVJ rekomandon një rishikim më thelbësor që prek ndryshimin e lëndëve dhe moduleve të këtij programi deri në masën 20%. Disa lëndë janë shumë specifike dhe të avancuara për një program “Bachelor” dhe mund të zvëndësohen me lëndë më bazike dhe formuese për studentët e programit të ciklit të parë. Këto ndryshime janë më të rëndësishme sidomos në lëndët me zgjedhje.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Shqipëri”, dhe VKM, nr. 41 datë.24. 01.2018. Shpërndarja e ngarkesës lëndore përcaktohet qartë në syllabusin e secilës lëndë.</p> <p>Sikundër citohet edhe në RVB, referuar kornizës ligjore kombëtare, një kredit (ECTS) korrespondon me 25 orë pune të një student dhe sasia mesatare e punës së përfunduar gjatë një viti të studimeve për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë të orarit të punës së studentëve, i cili përfshin orë në auditor dhe orë të punës së pavarur. Programi mësimor është i ndërtuar nga 4500 orë studimi në total, nga të cilat 1893 janë orë studimi në auditor dhe 2607 janë orë studimi individual. Ngarkesa mësimore është e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit. Përgjegjesi i Departamentit përcakton ngarkesën mësimore të vitit akademik.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ duke iu refruar përmbajtjes së programit, emërtesës së lëndëve, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të siguruar nga takimet me stafin akademik dhe studentët e programit është e mendimit se lëndët janë të përcaktuara dhe të shpërndara në mënyrë që të mundësojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve.</p> <p>Shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, integruese dhe plotësuese, ndihmon studentët të fitojnë njohuri, të përmirësojnë aftësitë dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre, siç shprehet edhe në planin strategjik të departamentit. (<i>Evidencë nr.I.3</i>).</p> <p>Studentët e psikologjisë që mbarojnë programin e ciklit të parë, në bazë të ligjit për Urdhrin e Psikologut, nuk mund të punojnë dhe veprimtaritë nuk mund të ndikojnë në formimin e tyre të punësimit. Të gjitha praktikat mundësojnë njohuritë e duhura për studentët e psikologjisë si edhe vëzhgimin nga afër të mënyrës sësi ushtrohet profesioni.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstatoi se të gjitha lëndët e programit të studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” janë të shpërndara në semetra në bazë të ligjit të arsimit të lartë dhe rregullores së programit të studimit me qëllim rritjen e rezultatit në procesin e të nxënit.</p> <p>Ndarja e lëndëve në vite, semestra dhe kredite nxit arritjen e objektivave të programit të studimit, rezultateve të pritura dhe rezultateve të mësimin siç përcaktohet në kurrikulën e programit të studimit. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” ndjek një hierarki të tillë ku fillimisht studentët marrin njohuri të përgjithshme teorike duke kaluar gradualisht në njohuri më specifike dhe praktike. Pra, ky program mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi, strukturën e programit të studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme” dhe lëndët e ciklit të parë konstatoi se ky program është i përafërt dhe i ngjashëm me programet e shumë universiteteve të tjera publike dhe private. Plani mësimor i programit të studimit lëndët dhe përcaktimet e tyre në semestra, kredite, teori apo praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe i ngjashëm me programet ndërkombëtare.</p> <p>Referuar (<i>tabelës nr 3 dhe asaj që citohet në RVB</i>), veprimtaritë formuese janë të ndara në;</p> <p>leksione – 927 orë;</p> <p>seminare/ushtrime – 742 orë;</p> <p>detyra kursi - 24 orë;</p>

	<p>praktikë mësimore – 207 orë;</p> <p>Ngjashmëritë e disa lëndëve mund të lidhen edhe me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithëshme” është i ndarë sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe transferim të studimeve. Programi është organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të parë.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i Kurrikulës së Programit, konstaton se, ngarkesa në auditor është 1900 ore, ndër të cilat 927, orë janë leksione, 481 orë janë seminare, 261 orë ushtrime, 12 orë detyra dhe projekte, 207 orë praktikë profesionale dhe 12 orë Projekti i Diplomës. (Tabela 13)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet e lëndëve dhe moduleve përditësohen duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit me qëllim që të korrigjohen problemet që janë ndeshur gjatë procesit mësimor dhe të përmirësohen dhe përditësohen elementë të ndryshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Gjithsesi GVJ rekomandon, një përditësim më thelbësor që prek ndryshimin e lëndëve dhe moduleve të këtij programi. Disa lëndë janë shumë specifike dhe të avancuara për një program “Bachelor” dhe mund të zvëndësohen me lëndë më bazike dhe formuese për studentët e programit të ciklit të parë.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstatoi se përmbajtja e programeve të studimit “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithëshme” është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Lëndet dhe modulet mundësojnë zhvillimin e njohurive dhe fitimin e aftësitë të studentëve. Të gjitha praktikat mundësojnë njohuritë e duhura për studentët e psikologjisë si edhe vëzhgimin nga afër të mënyrës se si ushtrohet profesioni.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Në bazë të ligjit për Urdhrin e Psikologut, studentët e diplomuar në “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithëshme” nuk mund të punojnë dhe përmbajtja e programit të studimit mund të mundësojë vetëm vijimin e mëtejshëm të studimeve. GVJ konstatoi se përmbajtja e programit Bachelor në “Psikologji e Përgjithëshme” mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në të gjitha specialitetet e psikologjisë dhe në çdo program master profesional ose shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa</p>	<p>Referuar DVV, vizitës në institucion për përmirësimin e programeve të studimit departamenti ngre grupin e punës ë përbërë nga pedagogë me grada dhe tituj, por në të njëjtën kohë profesionistë të fushës, të</p>

më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	cilët sjellin propozime mbështetur dhe në eksperiencat e bashkëpunëtorëve nga tregu i punës. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit krahas studimit të tregut, Departamenti i Psikologjisë konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Gjithashtu, ne si GVJ rekomanduam përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe ky rekomandim u mirëprit nga të gjithë aktorët.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se institucioni i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Baza ligjore për rekrutimin e personelit mbështet në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë si edhe në Statutin dhe Rregulloren Universitetit. Vendet vakante dhe kriteret përkatëse shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Ky fakt u konfirmua edhe nga Dekani aktual i komanduar që kishte vetëm pak muaj që ishte punësuar në atë detyrë. Procedurat ligjore të rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	GVJ konstatoi se, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit “Bachelor” në “Psikologji” kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik, por kanë nevojë edhe të përmirësohen.  Referuar (tabelave 6.2, 6.3, 6.4 RVB) dhe dokumentit (Stafi 20-21 per program studimi) të kërkuar gjatë vizitës në institucion, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë:  Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 16 pedagogë ndër të cilët 11 PAE dhe 5 PAK.
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e	Mbulimi i programit në përqindje është 69% PAE dhe 31% PAK.



<p>anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë të angazhuar <b>21</b> pedagogë ndër të cilët <b>8 PAE</b> dhe <b>13 PAK</b>.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>38% PAE</b> dhe <b>62% PAK</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019</b> janë të angazhuar <b>21</b> pedagogë ndër të cilët <b>9 PAE</b> dhe <b>12 PAK</b>.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>42% PAE</b> dhe <b>58% PAK</b>.</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të PA:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për 2018 -2019, 62% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 38% janë Msc;</li> <li>- Për 2019-2020, 57% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 43% janë Msc;</li> <li>- Për 2020-2021, 63% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 37% janë Msc.</li> </ul> <p><b><i>GVJ vlerësoi faktin së 6 anëtarë me kohë të plotë përmbushin detyrimin me tituj dhe gradë shkencore, por rekomandojmë që stafi të shtohet me pedagogë që kanë formim bazë në psikologji si një vlerë e shtuar për programin e studimit.</i></b></p> <p>Ne si GVJ rekomandojmë që pedagogët e rinj të jenë edhe me formim bazë në psikologji dhe të liçensuar nga Urdhri i Psikologut. Gjithashtu, GVJ konstatoi se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve dhe angazhimet kërkimore-shkencore të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji”.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në kontekstin e zbatueshmërisë së marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, institucioni vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, të programit të studimit. Departamenti i psikologjisë në bashkëpunim me njësinë kërkimore shkencore të fakultetit, promovon studime me natyrë krahasuese të pedagogëve dhe studentëve në fushat e psikologjisë, sociologjisë, edukimit etj, të cilat i boton në revistën shkencore <i>Optime</i> të universitetit. Gjithashtu, departamenti është fokusuar në organizimin e konferencave, seminareve e tryezave të përbashkëta, duke synuar forcimin dhe zgjerimin dhe shkëmbimin e përvojave akademike dhe të rejat shkencore kryesisht në nivel kombëtar dhe më pak në atë ndërkombëtar.</p> <p>Ajo që u konstatua bazuar në vizitën në institucion lidhet me faktin se për mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale janë</p>

	<p>hartuar marrëveshje me institucione që mundësojnë aftësimin praktik të studentëve si psh. shkolla publike dhe jopublike, kopshte, institucione dhe organizata. Referuar RVB praktika është e konceptuar si praktikë shëtitëse në disa institucione, dhe jo si praktikë e stacionuar në një institucion të vetëm. Qëllimi për këtë zgjedhje është që studentët e vitit të fundit të kenë mundësi të shohin një gamë të gjerë të mundësive për punësim të psikologëve në kontekstin shqiptar dhe të marrin njohuri mbi punën konkrete që psikologët kryejnë. Ndërkohë sic citohet sërish në raport, ndarja e studentëve që bëjnë provim final apo punim diplome bazohet në rregulloren programit të studimit (<i>Evidencë nr. I.5</i>), dhe “Manuali i punimit të një teme diplome” (<i>Evidencë nr. II.5</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Duke u bazuar në faktin që programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji” është program i ciklit të parë me natyrë sociale dhe nuk synon që të nxjerrë psikolog menjëherë në tregun e punës nuk është parë e domosdoshme ngritja e laboratorëve. Gjithësesi, në këtë program është vetëm laborator i informatikës.</p> <p>Stafi i IT në Albanian University mirëmban laboratorin dhe siguron që në momentin e zhvillimit të orëve laboratorike të gjitha pajisjet të jenë në kushte optimale.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Institucioni nuk ka hartuar një udhëzues të veçantë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, por ka ofruar trajnime specifike lidhur me platformat online. Kjo gjë u vu re në takimet që GVJ zhvilloi në institucion gjatë intervistave me grupe të ndryshme. Ndërkohë me periudhën e pandemisë duket që institucioni është përshtatur mjaftueshëm ku stafi është pajisur me udhëzuesin për platformën e miratuar në AU “Microsoft Teams” dhe ka marrë trajnimin e nevojshëm online për mënyrën e përdorimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila është njësi e ngritur në nivel institucional dhe e ushtron aktivitetin e saj në të gjitha programet. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) monitoron dhe vlerëson vazhdimisht mësimdhënien, ku çdo semestër zhvillon pyetësorin e studentëve si dhe harton raporte mbi pyetësorin e studentit dhe të pedagogëve. <i>(Evidencë nr. III.1)</i> Ajo gjithashtu organizon fokus grupe me studentët për të identifikuar problematikat lidhur me ecurinë e procesit mësimor. <i>(Evidencë nr. III.2)</i></p> <p>Referuar RVB dhe intervistave gjatë vizitës në institucion, u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit në fund të çdo semestri plotëson Formularin për stafin akademik. Në këtë formular paraqitet ecuria e punës së tyre gjatë semestrit për lëndët specifike. <i>(Evidencë nr.III.4)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik dhe ju mundëson studentëve takime me stafin akademik dhe administrativ në prani të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nxit shprehjen e opinioneve lidhur me procesin mësimor si dhe mundësinë e trajtimit të ankimeve. Nga intervistat gjatë vizitës në institucion, u konstatua se: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nëpërmjet plotësimit të pyetësorit nga studentët të organizuar dy herë në vit garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Ankesa i paraqitet përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit. Nëse verifikohet gabim</p>

	i korigjueshëm nga përgjegjësi i departamentit, ai në bashkëveprim me komisionin e provimit bëjnë korigjimin. Kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni Dekanin. Gjithsesi, GVJ konstatoi se nuk kishte procedura të dokumentuara për ankimimet dhe kryesisht ato ishin zgjidhur përmes rrugëve jo formale midis pedagogut dhe studentit.			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie publikon rezultatet e vlerësimit nëpërmjet raportit të përvitshëm. Këto të dhëna i vendosen në dispozicion Rektorit si dhe të gjitha palëve të përfshira në procesin e vlerësimit. Referuar edhe RVB, këto vlerësime bëhen pjesë e raportit të departamentit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	GVJ konstatoi se institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra ka nxjerrë konkluzione dhe rekomandime, plan masash lidhur me përmirësimin e cilësisë për procesin e mësimdhënies, apo nxitjen dhe inkurajimin e performancës së pedagogëve.  Ashtu sic citohet edhe në RVB, NJSBC zhvillon herë pas here seminare informuese, trajnime të stafit akademik në lidhje me komponentët e ndryshëm të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie.  (Evidencë nr. III. 5.a.b)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ pasi shqyrtoi ( <i>Syllabuset e programit të ciklit të parë "Bachelor" në "Psikologji"</i> ) konstatoi se pedagogët përdorin forma të ndryshme në mënyrën sesi ato zhvillojnë orën e leksionit apo seminarit, duke përdorur mjete audio-vizive, power-point, role play, diskutime, etj. Në të gjitha syllabuset janë të përcaktuara format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive. Studentët njihen me përmbajtjen e plan programeve që në fillim të vitit akademik. Lektorët e lëndëve përkatëse javën e parë të lëndës apo modulit, bëjnë një prezantim lidhur me përmbajtjen, orët në dispozicion, mënyrën e organizimit e më gjerë. Në plan programe

	janë të përcaktuara gjithashtu më së miri të gjitha format e vlerësimit. Ajo që vihet re është unifikimi në vlerësim për cdo lëndë.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Duke u ndihmuar edhe nga numri i vogël i studentëve, personeli akademik për të rritur cilësinë e mësimdhënies, nxit studentin për të qenë pjesë aktive e procesit mësimor nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive, luajtjes së roleve, prezantimit të rasteve, të cilat shoqërohen nga një përdorim i vazhdueshëm i mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit, të cilat ndihmojnë në prezantime më cilësore. Kjo gjë u konstatua gjatë intervistave që u zhvilluan nga GVJ me studentë, pedagogë si dhe nga shqyrtimi i plan programeve për lëndët.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	GVJ konstatoi se institucioni herë pas here mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike duke organizuar trajnime për stafin akademik në funksion të përmirësimit të kompetencave didaktike me specialistë të fushave përkatëse. Nga intervista e zhvilluar me pedagogët me kohë të plotë, u vu re që institucioni organizonte orë të hapura në auditor dhe online për të përmirësuar njohuritë e stafit akademik dhe me gjerë. Për përmbushjen e objektivave dhe për realizimin e pritshmerive të pedagogëve si për procesin e mësimdhënies dhe atë të mësimnxënies, institucioni mundëson pajisje didaktike për realizimin e orëve të leksioneve dhe të seminareve me metoda dhe mjete të ndryshme e të shumëllojshme. Infrastruktura është në nivele shumë optimale. Kjo u vu re gjatë vizitës në institucion. Sallat ishin të pajisura me kompjutera dhe video – projektor.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	GVJ konstatoi se në fillim të vitit akademik, stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie diskuton dhe shqyrton lidhur me përditësimin e plan programeve të lëndëve (syllabuset) në elementë të caktuar të tij (të rejat e fundit të lëndës, teknologjitë inovative, literatura e përditësuar) etj. Përgjegjësi i Departamentit citon në intervistën e zhvilluar me të, që bën ndarjen e lëndëve sipas profilit të personelit akademik bazuar në kualifikimin dhe gradat e secilit pedagog. Megjithatë është një departament i vogël me një numër të ulët studentësh ne rekomandojmë që ne punësimet e reja pedagogët të kenë formim bazë në psikologji si një mënyrë për të rritur cilësinë e programit. Të gjitha këto u diskutuan edhe në takim me përgjegjësen e departamentit. <b><i>Sidomos lëndët me profil klinik duhet të mbulohen nga ekspertë të fushës.</i></b>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe	GVJ konstatoi se personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces. Për sigurimin e cilësisë, Njësisa e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon në rrugë të drejtpërdrejta

duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	takime/biseda të drejtuesve të institucionit me studentët si edhe përdor periodikisht pyetësorët me student. Pas procesit të përpunimit të këtyre gjetjeve, informacioni përkatës i kalon pedagogut përkatës, i cili ky i fundit bazuar në nevojat, mendimet e sugjerimet e studentëve vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies. Këto janë procese shumë pozitive për të përmirësuar format e mësimdhënies. Gjithashtu cdo pedagog plotëson edhe formularin e vetëvlerësimit duke theksuar sfidat dhe arritjet gjatë zhvillimit të lëndës apo modulit. Në fund ai jep sugjerimet për vitin e ardhshëm nëse ka vend për përmirësime. (Evidencë nr. III.6)			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi për kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës individuale të studentëve (nëpërmjet rasteve të studimit apo detyrave të kursit, eseve, prezantimeve), në mënyrë që, orët e mësimi të bëhen sa më tërheqëse. Psh, përdorimi i teknikave të ndryshme si ajo e karriges bosh, role-playing, psikodrama, meditimi etj.  Bazuar në RVB, citojmë se në edhe në këtë institucion vlerësimi bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Ajo që vihet re është sistemi i unifikuar për të gjitha lëndët. Studentët në syllabus kanë sistemin e pikëzimit të njëjtë në të gjitha lëndët, gjë që shihet si anë positive.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ konstatoi se marrëdhëniet pedagogë – studentë, karakterizohen nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi që lehtësohet nga numri i vogël i studentëve. Kjo gjë u vu në takimin e zhvilluar me studentët. Ata janë të lirshëm të shprehin opinionin dhe qëndrimin e tyre. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të mësimdhënies dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të punës dhe të respektit të ndërsjellë mes tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ konstatoi se procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme, moderne dhe cilësore, për shkak të hapësirave të dedikuara në mjedise të veçanta për zhvillimin e orëve të mësimi. Mjediset fizike janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht si rezultat i numrit të mjaftueshëm të stafit në strukturën mirëmbajtjes së hapësirës fizike dhe higjenes. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të plota për të gjithë studentët. Ky fakt ndikohet edhe nga numri i vogël i studentëve sidomos për këtë program studimi. Gjithashtu, infrastruktura e ofruar nga institucioni përsa i përket logjistikës siguron në çdo sallë forma të larmishme të teknologjisë së informacionit si Wifi, laptop, videoprojektor, monitor etj, në mbarëvajtjen e procesit mësimor cilësor për Programin e Studimit “Bachelor” në “Psikologji”. Edhe salla e konferencave është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme në varësi të kërkesave që ka departamenti. GVJ vizitoi ambjentet dhe konstatoi që kushtet janë optimale për një mbarëvajtje normale të procesit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka 1 sallë interneti të pajisur me kompjutera, edhe biblioteka është e pajisur me kompjuter ku studentët mund të hyjnë online për të kërkuar informacion. Gjithashtu, personeli akademik aktualisht zhvillon mësim online përmes platformës Teams dhe suportohet nëse ka nevojë. Institucioni ka siguruar të gjitha mjetet e nevojshme në auditore për zhvillimin e procesit mësimor. Pajisjet kompjuterike, audio, vizuale, didaktike etj, plotësojnë më së miri funksionin e tyre në kuadër të mirëfunksionimi të programeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse janë vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse janë vënë në dispozicion të studentëve. Si në të gjitha programet e psikologjisë në vend, vlen që të theksohet se literatura në gjuhën shqipe është e kufizuar dhe ka më shumë literaturë në gjuhën angleze. Institucioni duke u bazuar edhe në rekomandimin e dalë nga procesi i mëparshëm i akreditimit ka zhvilluar bibliotekën dhe rritur ndjeshëm numrin e fondit të librave.</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar (<i>Evidencë nr.III.7</i>) si dhe RVB konstatojmë se në bibliotekën e godinës qendrore janë rreth 172 tituj të disponueshëm për pedagogët dhe studentët, të cilët janë në ndihmë të programeve të studimit që ofron departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme. Në dispozicion të studentëve të</p>

	<p>programit të studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” janë dhe bibliotekat on line:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Questia (abonim me të drejta të plota)</li> <li>- Elsevier</li> <li>- Getty</li> <li>- ERIC – Education Resources Information Center</li> </ul> <p>Ne si GVJ konstatuam se në bibliotekë gjenden literatura bazë në versionin fizik në gjuhën shqipe dhe literature mbështetëse në version fizik dhe elektronik në gjuhën shqipe dhe të huaj sipas rastit. Pedagogët kanë lënë kopje të botimeve të tyre në fushën e psikologjisë dhe biblioteka pasurohet vazhdimisht.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka funksionon mbi bazën e rregulloreje të brendshme, e cila vendos rregullat normative të subjekteve të ndryshme në lidhje me bibliotekën, rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit të bibliotekës</p> <p>Biblioteka punon gjatë orarit 08.00-16:00. Në rastet kur studentët e fundjavës kanë nevojë për të marrë materiale të ndryshme, biblioteka funksiononte edhe jashtë orarit zyrtar. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Biblioteka ka orarin e shërbimeve ekstra edhe në përputhje me oraret mësimore të studentëve për sezone të veçanta. Gjithashtu, gjenden në bibliotekë tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse për studentët, përkthime të ndryshme, fjalorë, CD- ROM etj.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës mori informacion lidhur me librarinë dhe aksesin online. Ajo që u konstatua lidhet me faktin që në funksion të programit të studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” libreria on line “QUESTIA”, ka rreth 83,000 libra akademike dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë. Gjithashtu revista e universitetit “Optime” ka botime periodike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore me autor nga stafi akademik i institucionit dhe më gjerë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për shkak të natyrës sociale të programit të studimit “Bachelor” në “Psikologji” nuk është parë e arsyeshme përdorimi i laboratorëve për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të programit. Institucioni nuk siguron një laborator në fushën e psikologjisë, referuar kjo konstatimeve gjatë vizitës dhe intervistave në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-</p>	<p>GVJ konstatoi se gjatë situatës së pandemisë mësimi është zhvilluar dhe vazhdon ende online për të gjithë studentët e “Albanian University” në platformën Microsoft teams. Nga intervista e</p>



line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	zhvilluar me studentët dhe stafin akademik u konfirmua që studentët kanë qenë aktiv gjatë mësimin online, kanë ndjekur rregullisht leksionet, seminarët si dhe janë përfshirë në detyrat e paracaktuara të lëndës. Edhe provimet janë zhvilluar normalisht përmes platformave të dakorduara më parë.								
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	GVJ konstatoi se ambientet e punës janë të pajisur me kompjuter me akses në internet dhe komunikimi mes stafit pedagogjik dhe administrativ zhvillohet nëpërmjet adresave zyrtare; institucioni ka adresa IP që mundësojnë aksesin e Bibliotekës online, nëpërmjet domain-it të institucionit.								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Gjatë intervistave të zhvilluara me studentët dhe stafin akademik, u konstatua që jo të gjithë studentët kanë të drejtë të zgjedhin një punim diplome. Ndarja e tyre bëhet bazuar në Rregulloren e programit të studimit, ku studentët të cilët kanë mesatare mbi 8.5 kanë të drejtë të zgjedhin mbi mënyrë e diplomimit me temë diplome. Të gjithë studentët të cilët nuk e arrijnë këtë mesatare detyrimisht i nënshtrohen kontrollit të dijeve nëpërmjet provimit të diplomimit. Ky fakt u konfirmua edhe nga studentët edhe nga pedagogët.  GVJ pasi shqyrtoi rregulloren “Mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji” konstatoi se personeli akademik i orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave duke organizuar takime periodike me studentët që plotësojnë kriterin për përzgjedhjen e temës së Diplomës.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë	Departamenti i Psikologjisë është njësi bazë, që aktualisht ofron programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji”. Gjithashtu, institucioni ka ngritur komisionet e përhershme, të cilat janë organe kolegjiale, që kryejnë funksione, që lidhen kryesisht me, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit,

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit. Albanian University ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është një strukturë autonome, e përhershme që vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, harton relacione dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Të gjitha strukturat koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetin e tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti i Psikologjisë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. Universiteti përdor të dhëna të ndryshme përmes pyetësorve, raporteve, formularëve dhe fokus grupeve lidhur me vlerësimin e lëndëve të tij, programeve të studimit dhe mësimdhënies, duke përfshirë komente nga studentët dhe palët e interesuara. Në këtë mënyrë, ashtu sic citohet edhe në RVB synohet të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton gjatë intervistave me të gjitha grupet e interes, se gjatë një periudhe të gjatë Departamenti i Psikologjisë ka orientuar veprimtarinë e tij në ofrimin bashkëkohor të programeve në fushën e psikologjisë dhe angazhimin e studentëve në eksperiencë, aktivitete të ndryshme, si dhe shfrytëzimi i të gjitha mundësive që ofrohen nga organizata të ndryshme në fushën e psikologjisë; Ndërtimi i marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit me organizata vendase dhe të huaja, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, kryerjen e projekteve/detyrave të kursit, studime kërkimi dhe zhvillimi etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstatoi se strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies duke organizuar aktivitete kërkimore-shkencore ose trajnuese/orientuese për eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, GVJ vuri re se aktivitetet kryesore mund të konsiderohen:</p> <p>Leksione të Hapura në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë;</p> <p>Konferenca Studentore Ndëruniversitare në bashkëpunim me Universitete publike dhe jopublike;</p> <p>Organizimi i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare etj;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në</p>	<p>Referuar dokumentacionit që ka atashuar vetë institucioni, por edhe përgjigjeve të marra nga intervistat e zhvilluara, duket qartë që Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me</p>

<p>fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme organizojnë workshop-e, trajnime dhe aktivitete me tematika të ndryshme të mbajtura nga trajnues kombëtar dhe ndërkombëtarë në mënyrë që të përmirësojnë: aktivitete e mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>(Evidencë nr. III.8)</i></p> <p>GVJ konstatoi se personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen brenda mundësive të një departamenti të vogël me buxhet të kufizuar në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Vlen që të theksohet se personeli akademik efektiv është angazhuar në Konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka publikuar në revista periodike të huaja dhe në vend, <i>por, do të ishte mire që të mbështeteshin edhe me buxhet për të marrë pjesë në konferenca dhe kongrese në nivel ndërkombëtar.</i></p> <p>Gjithashtu një pjesë e tyre janë angazhuar rregullisht në aktivitetet në fushën e kërkimit shkencor që organizohen nga institucioni, siç janë Konferencat shkencore ndërkomëbtare dhe kombëtare, si dhe në fushën e botimeve të punimeve shkencore në Revistën Periodike Optime.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstatoi se strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj. Ky fakt u konstatua gjatë intervistës me stafin akademik ku një nga lektorët citoi që pritej së shpejti një bashkëpunim me një profesor nga një universitet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli ndihmës akademik është i angazhuar në implementimin e metodave të reja duke frekuentuar takimet dhe ëorkshop-et e organizuara nga Departamenti i Psikologjisë dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Aktualisht i gjithë stafi trajnohet edhe për mësimin online, organizimin e ushtrimeve, seminareve apo provimeve.</p> <p>Çdo lëndë është hartuar në mënyrë që të kontribuojë në përvetësimin e njohurive duke konkretizuar me shembuj dhe ushtrime në varësi të lëndës dhe programit të studimit. Lektori i referohet planit mësimor të programit të studimit si dhe në mënyrë të veçantë syllabusit të lëndës përkatëse. Ajo që u konstatua nga vetë përgjegjësja e departamentit lidhej me faktin se në fillim të viti akademik lektori i lëndës ka të drejtë të përmirësojë syllabusin e lëndës në përmbajtje dhe organizim.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të</p>

<p>mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Strukturat mbështetëse dhe njësitë ndihmëse didaktike, të cilat në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë të institucionit, luajnë një funksion të rëndësishëm në realizimin e misionit të programeve të studimit dhe të institucionit në tërësi. Strukturat përkatëse mbështesin dhe bashkëpunojnë me institucionin në drejtim të formimit të shprehive aplikative e praktike të stafit dhe studentëve; të realizimit të studimeve kërkimore – shkencore e më gjerë. Një bashkërendim maksimal shihet gjatë periudhës së pandemise ku të gjitha departamentet janë në bashkëpunim të vazhdueshëm.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni sanksion mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale në rregullore. GVJ konsultoi rregulloren e programit e cila jep informacion prej vlerësimit në nenet 18 - 25.</p> <p>Edhe në syllabusin e lëndëve përcaktohet mënyra e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet që ata kanë në secilën lëndë. Aty thuhet qartë që në vlerësimin e arritjeve të studentit, pedagogu mbështetet në përfundimet e vlerësimit të vijueshëm, në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, detyra kursi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ në takimet e zhvilluara me studentë dhe personel akademik, si dhe duke u konsultuar me rregulloren e departamentit konstaton që studentët informohen që në takimin e parë informues me pedagogun për çdo element që lidhet me procesin mësimor akademik, metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Kjo gjë u bëhet e ditur në javën e parë orientuese. Ata njihen me kompetencat e lëndës; përshkrimin e lëndës; rezultatet e mësimnxënies; metodat e vlerësimit të lëndës etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme,</p>	<p>Pavarësisht se cdo lëndë apo modul ka specifikat e veta, sistemi i pikëzimit është unifikuar për të gjithë programin bachelor. Pra në</p>

<p>duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>cdo lënde studentët kanë të njëjtat pikë për provimin, detyrat, punën në klasë etj.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bëhet:</p> <p>60% në provimin final;</p> <p>20% provimi ndërmjetëm;</p> <p>10% puna në klasë;</p> <p>10% detyra e kursit;</p> <p>Studentët janë të njohur me sistemin e vlerësimit në fillim të cdo semestri dhe e dinë si është e organizuar lënda. Kjo pasqyrohet në syllabuset e secilës lëndë. Kryesisht institucioni u rekomandon pedagogëve të përdorim pyetje me zhvillim më së shumti dhe sa më pak pyetje me alternative, gjë që u konstatua nga intervista edhe me stafin akademik. Kontrolli njohurive përcaktohet në Rregulloren e programit. (Evidencë nr I.5)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b></p>	
<p><b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Ashtu sikundër citohet edhe ne RVB, studenti në “Albanian University” vlerësohet dhe monitorohet në marrjen e njohurive përgjatë gjithë vitit akademik. Zhvillimi i detyrave të kursit, projekteve, eseve; provimi i ndërmjetëm si dhe provimi përfundimtar janë të shtrira përgjatë gjithë semestrit dhe pa diskutim përgjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>Pedagogu zhvillon herë pas here ushtrime dhe seanca vlerësuese apo ese, të cilat mbartin 10% të vlerësimit, pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare mbartin deri në 10% të vlerësimit përfundimtar. Provimi përfundimtar i realizuar në fund të semestrit mbart 60 % e notës përfundimtare dhe provimi ndërmjetëm 20%. Në këtë mënyrë institucioni i garanton studentit testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale gjatë gjithë vitit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat</p>	<p>GVJ në takimet e zhvilluara me student dhe pedagog nuk konstatoi raste abuzimi apo gjykimi subjektiv të tyre. Studentët shprehën konsideratën e tyre lidhur me të gjithë mënyrën e organizimit të mësimit në atë institucion, vlerësimet e tyre si dhe marrëdhëniet</p>


eliminonjë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	mes stafit akademik dhe atij administrativ. Vlen të theksohet këtu që u takuan vetëm student të vitit të tretë dhe jo studentë të viteve të tjera. Në intervistë me ta nuk u paraqit ndonjë rast problematik që kish mbetur i pazgjidhur. Të gjitha provimet janë të sekretuara dhe hapja e emrave bëhet në departament. Më pas pedagogu përllorarit pikët dhe notën.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e departamentit citohet qartë që përgjegjësi i departamentit miraton modalitetet e testimit dhe vlerësimin njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të cilat realizohen nga komisionet e provimeve me së paku dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. Kjo gjë vihet re edhe në procesverbalet e dorëzuara në sekretari ku në cdo lëndë janë në komision dy pedagog, gjë që u konstatua edhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	GVJ bazuar në rregulloren e departamentit dhe asaj që vëzhgoi apo intervistoi gjatë vizitës në institucion, konstatoi që “Albanian University” siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi për testimin e vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim. Ky proces zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim, e cila përcaktohet në rregulloret e Sekretarisë mësimore. Në cdo provim një përfaqësuese nga sekretaria mbyll tezat dhe më pas i hap sërish pasi ato janë korrigjuar nga departamenti. Cdo student ka një barkod dhe përmes tij identifikohet.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Niveli i formimit të studentit vlerësohet në cdo rast nëpërmjet ndërveprimit të vijueshëm të pedagogut me studentin. Ata testohen dhe vlerësohen në mënyrë periodike sic u citua edhe më sipër. GVJ këtë gjë e konstatoi gjatë intervistës me studentët, ku ata u shprehën si ishin vlerësuar në lëndë të ndryshme gjatë studimeve të tyre. Nota në cdo modul është një shumatore e testeve, punës në klasë dhe detyrave apo projekteve të kursit. Këto përcaktohen qartë në syllabus dhe studentët janë të informuar që në fillim të semestrit. Secili prej tyre e di si do vlerësohet në secilën lëndë.
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Personeli akademik në këtë institucion si në cdo institucion tjetër të Arsimit të Lartë shmangin plagjiaturën dhe nuk tolerojnë kopjimin nga ana e studentëve në provime dhe detyra. GVJ konstatoi që të gjitha procedurat mbi përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira gjenden në Rregulloren e programit të studimit, Kreu V. Disa nga këto masa disiplinore në rast shkeljeje dhe abuzimi janë këshillim me shkrim, vërejtje me shkrim, apo pezullim për atë vit akademik etj.
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi	Nga vëzhgimet, intervistat dhe shqyrtimi dokumentacionit, GVJ konstatoi se kontrolli i dijeve dhe aftësive profesionale bazohet

<p>meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>mbi meritën dhe jepet në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p>Referuar edhe asaj që shkruhet në RVB, stafi akademik ka një afat 7 ditor për vlerësimin dhe paraqitjen e rezultateve pranë sekretarisë mësimore. Sekretaria mësimore njih më pas studentët me rezultatet përkatëse.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit janë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve. Ndër një sërë të drejtash në rregullore përcaktohet se studenti ka të drejtën të bëjë kërkesë dhe ankesë për rivlerësim kur ai mendon se vlerësimi për të nuk është i drejtë, si dhe ka të drejtë për një vlerësim të drejtë dhe objektiv të dijeve dhe të ecurisë së tij për gjatë gjithë viteve të studimit</p> <p>Studentët njiheshin me vlerësimin e tyre nëpërmjet platformës online aktualisht por edhe në takimet që zhvillonte pedagogu i lëndës për të parë të gjitha pikët që ata kishin grumbulluar (kjo gjë jo shumë e aplikueshme tani në periudhën e pandemisë). Në rastet kur studenti nuk ishte dakord mund të ndiqte procedurat e caktuara të ankimit. Sipas punonjësve në institucion nuk kishin patur raste të tilla të mbetura pa zgjidhje. Kryesisht jepeshin edhe zgjidhje të shpejta informale.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në RVB konstatoi se nëse studenti nuk është i qartë nga sqarimi që bën me pedagogun e lëndës atëherë ngrihet komisioni për rivlerësimin e tezës. Komisioni është i përbërë nga njohës shumë të mirë të fushës përkatëse. Ata japin më pas një vlerësim mbi pikët që fiton student bazuar në atë që ka shkruar. E gjithë procedura mbi ankimitin e provimit dokumentohet dhe ruhet në arkivat e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme. GVJ konstatoi që të gjitha procedurat ndiqeshin sipas rregullores, edhe pse nuk kishte raste flagrante.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Albanian University ofron programe studime të cilat janë në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji” synon që të formojë profesionistë të kualifikuar në fushën e psikologjisë si edhe të rrisë vetëdijen qytetare dhe morale tek studentët duke reflektuar vlerat më të larta morale dhe etike në shërbim të grupeve vulnerablë në veçanti dhe shoqërisë Shqiptare në tërësi. Ky program synon që të formojë studentë të aftë për ruajtjen, konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vlerave kulturore, kombëtare si respekti, gjuha, historia, simbolet kombëtare dhe traditat. Kurrikula e programit është e organizuar në mënyrë që ti pajisë studentët me aftësi dhe njohuri të thelluara psikologjike</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit Bsc në Psikologji e Përgjithshme, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, institucioni siguron informacion mbi cilësinë e aftësive që ata fitojnë.</p> <p>Në përfundim të çdo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon dhe shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti. GVJ konstaton se të gjitha këto reflektohen në raportin e vetëvlerësimit. (Evidencë nr. III.6)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>GVJ bazuar në modelet e raportit semestral konstaton se në përfundim të çdo lënde personeli akademik harton një raport semestral. Aty paraqiten njohuritë që kanë përfutur studentët si dhe elementët më të rëndësishëm që mund të përmirësohen.</p> <p>Për të kapërcyer hendekun midis teorisë dhe praktikës, pedagogët përfshijnë studimet e rasteve, të dhënat reale dhe aplikimet në planin e tyre mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme orë të hapura për studentët ku kanë qenë të ftuar lektor të fushës brenda dhe jashtë vendit. Ky proces është zhvilluar shumë gjatë periudhës së pandemisë ku institucioni ka zhvilluar leksione online dhe konferenca me tematika nga më të ndryshmet.</p> <p>Të gjitha aktivitetet e realizuara janë të pasqyruara në Raportin e kërkimit shkencor si dhe në Raportin semestral apo vjetor të departamentit. (Evidencë nr. III.9)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë</p>	<p>Lëndët që zhvillohen përgjatë tre viteve të studimit hedhin baza drejt formimit të profesionistëve, pasi kombinimi i njohurive të thelluara teorike me ato praktike, kërkimi shkencor që ata kryejnë, bëjnë të mundur formimin e studentëve me aftësi e kompetenca</p>





<p>njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>profesionale. Në këtë drejtim GVJ konstaton që programi ekzistues bachelor në psikologji ka nevojë për disa <b>përmirësime në kurrikul lidhur me disa lëndë me zgjedhje</b>, gjë për të cilat u diskutua edhe në takim me drejtuesen e departamentit. Këto ndryshime janë të realizueshme pasi përbëjnë jo më shumë se 20% të planit mësimor. Përgjegjësja e departamentit e mori në konsideratë rekomandimin e dhënë nga GVJ.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Gjatë realizimit të orëve të seminareve, personeli akademik mundëson dhe mbështet disa nga format dhe mënyrat e mësimdhënies sic janë diskutimet dhe puna në grup, kjo me qëllimin për të identifikuar dhe interpretuar, zgjidhur çështje dhe problematika të caktuara. Kjo gjë u konstatua gjatë intervistave të zhvilluara me studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Duke qënë klasa me numër të vogël studentësh, orët e mësimi zhvillohen në mënyrë praktike duke i konkretizuar me raste nga situata të ndryshme të jetës. Orët janë interaktive dhe synohet të trajtohet pjesa më e madhe e informacionit të dhënë në leksione. Edhe ambjentet e klasave e mundësojnë organizimin e focus grupeve apo role – play në orë të ndryshme. Infrastruktura është në funksion të plotë të procesit mësimor.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Rederuar DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstaton që Institucioni organizon cdo vit konferenca studentore, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera. Së shpjeti pritej të zhvillohej një konferencë online me Universitetin e Elbasanit. Ndërkohë në RVB citohet gjithashtu se Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes organizon çdo vit akademik “Konferencën studentore” me tematika aktuale.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Albanian University në bashkëpunim me personelin akademik bën të mundur ndërthurjen e formave të mësimdhënies me institucione të ndryshme, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. (<i>Evidencë nr. I.7</i>)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi III.8**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton në takimet e zhvilluara dhe dokumentacionin bazë se Albanian University ka hartuar procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p>Ekzistojnë dy mënyra të mbrojtjes së diplomës:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. me provim të përgjithshëm përfundimtar;</li> <li>2. me temë diplome;</li> </ol> <p>Kjo përzgjedhje bazohet në nivelin e notës mesatare të studentëve. Studenti mund të diplomohet me temë diplome nëse niveli i notës mesatare për programin e studimit është 8.5. Nga të dhënat e mbledhura u identifikua që një numër shumë i ulët studentësh zgjedhin punim diplome, pasi pjesa më e madhe kërkojnë ta mbrojnë me provim. Në rastin kur studentët zgjedhin provimin përzgjidhen lëndë nga të tre vitet dhe u vihen në dijeni paraprakisht studentëve. Një muaj përpara datës së provimit të diplomimit njësia bazë organizon orë konsultime me studentët dhe stafin akademik. Institucioni ka miratuar dhe disponon gjithashtu manuali “<i>Mbi zhvillimin e një teme diplome</i>” (Evidencë nr. II.5), në të cilën janë të përcaktuara standartet dhe rregullat e punimit. Kjo u është bërë e ditur studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>GVJ konstaton nga intervistat e zhvilluara se departamenti dhe stafi akademik kanë ofruar mbështetjen e nevojshme për të gjithë studentët që kanë zgjedhur të zhvillojnë një punim diplome, duke u ofruar materialet e nevojshme dhe supervizuar hap pas hapi në punën e tyre. Në të njëjtën kohë edhe studentët që zgjedhin ta mbrojnë diplomën me provim drejtohen dhe orientohen me pyetjet bazë dhe literaturën ku do të mbështeten.</p> <p>Në raport citohet gjithashtu që stafi akademik organizon në fund të semestrit të dytë të vitit të tretë, konsultimet e nevojshme mbi secilën lëndë që është pjesë e provimit final. Pedagogët udhëheqës orientojnë dhe udhëzojnë studentët në realizimin me sukses të punimit të diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit të psikologjisë janë përcaktuar të gjitha lëndët apo modulet që do përfshihen në provimin final. Studentët e vitit të tretë njihen me to në fillim të vitit akademik dhe marrin informacion nga pedagogët nëse është e nevojshme. Ata gjithashtu janë informuar që në bazë të mesatares mund të zgjedhin edhe të zhvillojnë punim diplome. Studentët janë të pajisur me programin bazë për provimin e formimit. Për realizimin e provimit përfundimtar propozohet komisioni nga departamenti dhe miratohet nga dekani i fakultetit.</p>

	Ky komision është i përbërë nga tre ose pesë anëtarë të stafit akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi dhe e njeh atë më së miri.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që procedurat janë të përcaktuara qartë sipas kritereve të arsimit të lartë. Secili student mund të marrë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat dhe hapat e kryerjes së një punimi diplome. Departamenti i pajis edhe me një manual orientues.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka institucioni me palë të tjera, studentët mund të zhvillojnë punët praktike, projektet e kursit apo matje të ndryshme për punimin e tyre të diplomës. Nga takimi i zhvilluar me studentët u konstatua që stafi akademik i orienton ata në takime individuale apo në grup dhe i mbështet hap pas hapi në punën e tyre.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ konstatoi që udhëheqësi i diplomës asiston studentin që nga momenti i përzgjedhjes së temës deri në datën e miratuar të mbrojtjes së temës së diplomës sipas udhëzuesve të miratuara.  Në fund të punimit të temës, përpara se studenti të bëjë dorëzimin e punimit në departament, udhëheqësi dorëzon "Formularin e Pedagogut Udhëheqës" ( <i>Evidencë nr.III.10</i> ), në të cilin ai jep vlerësimin e tij mbi punimin e zhvilluar nga student. Ky vlerësim i bashkangjitet punimit të studentit, por nuk ndikon aspak gjykimin që jep komisioni.  Përpara se studenti të bëjë mbrojtjen e temës, punimi vlerësohet edhe nga oponenti i caktuar paraprakisht nga departamenti. ( <i>Evidencë nr. III.11</i> ). Edhe ky vlerësim i bashkangjitet punimit. Në fund komisioni jep gjykimin final duke marrë edhe feedback nga udhëheqësi shkencor dhe oponenti.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit përfundimtar studentin vlerësohet me notë nga 4 në 10 si dhe me sistemin me shkronja nga F në A+. Mënyra e kalimit nga njëri sistem vlerësimi tek tjetri bëhet sipas një sistemi pikësh, i cili është shpjeguar qartë në Rregulloren e Departamentit të Psikologjisë dhe është i unifikuar për të gjithë institucionin.  Komisioni i punimit të diplomës duhet të jetë së paku me tre anëtar, sipas rregulloreve të miratuar. Udhëheqësi dhe recensenti duhet të mbajnë parasysh të gjitha kriteret e verësimit. Edhe vlerësimi i temës bëhet me sistemin e notave nga 4 në 10.
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga	Mbështetur në rregulloren e institucionit shohim që me përfundimin e studimeve dhe fitimin e krediteve të nevojshme, studentët që kanë plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe kanë dhënë provimin e formimit apo kanë mbrojtur punimin e diplomës pajisen

ministria përgjegjëse për arsimin.	me diplomën dhe suplementin e diplomës si dhe listën e notave të miratuara nga MASR. (Evidencë nr. III. 12.a.b.c)			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ mbështetur në informacionin e siguruar nga vizita në sekretarinë mësimore, rezulton se në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion, kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Nga vizita në sekretari u shqyrtuan të gjitha dokumentet e nevojshme dhe u konstatua që sekretaria mësimore ruan të gjithë dokumentacionet, për një periudhë të pacaktuar kohore, të studentit dhe e paraqet atë, nëse ato kërkohen nga ana e tyre			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në	Referuar RVB-së si dhe takimeve pranë ambjeteve të institucionit, Zyra e Burimeve Njerëzore mban dhe përditëson të dhëna të hollësishme në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit që mbulon (Evidencë RI.c.d.e), por nuk mban të dhënat për kërkimin shkencor që stafi akademik kryen. GVJ verifikoi në terren dosjet e personelit akademik pranë kësaj zyre. Dokumentacioni rezultoi i rregullt dhe i organizuar sipas departamenteve përkatëse.

<p>çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p><i>GVJ rekomandon specifikimin e ngarkesës mësimore sidomos për pedagogët me kohë të pjesshme, në kontratën e punës edhe për semestrin e dytë.</i></p> <p>Kjo gje bën që ky proces të jetë më transparent dhe në cdo moment kushdo mund të shohë lëndët e secilit pedagog me ngarkesat përkatëse. Në këtë mënyrë ne shohim një përputhje ndërmjet asaj që paraqet departamenti dhe ngarkesave që dokumenton kjo zyrë.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit që është dorëzuar dhe asaj që deklaruan përfaqësues të ndryshëm të institucionit, procedurat e rekrutimit ndiqnin udhëzimet përkatëse të kodit të punës duke nisur me shpalljen e njoftimit për punë, mbledhjen e dokumentacionit, intervistën e punës e kështu me radhë. Në këtë proces merr pjesë edhe zyra e burimeve njërzore, me përfaqësues nga departamentet përkatëse. AU shpall njoftimet për punë në faqen zyrtare: <a href="http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/">albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Sipas të dhënave të analizuara nga të gjitha burimet e cituara në raport, rekrutimi i personelit të ri është transparent dhe në përputhje me Kodin e Punës dhe aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti. Kandidati konkurron pas identifikimit të nevojave për të mbuluar ngarkesën mësimore.</p> <p>AU shpall njoftime për vende të lira pune të cilat publikohen edhe në faqen e zyrtare të AU:</p> <p>(<a href="http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/">http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/</a>)</p> <p>Departamenti në mbledhjet që zhvillon në fillim të vitit akademik liston lëndët që ka të pambuluara dhe për to nxjerr njoftim për staf akademik, i cili rekrutohet sipas procedurave standarde.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni shpall kritere të përgjithshme dhe specifike në bazë të nevojave që ka vetë departamenti për staf akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen zyrtare të Albanian University, si dhe në mjetet e tjera të informimit publik.</p> <p>Për të garantuar përzgjedhjen e personelit ngrihet një komision ad hoc i propozuar nga dekani dhe i miratuar nga rektori, “Komisioni i vlerësimit”, i përbërë nga përfaqësues të njësisë bazë dhe kryesore.</p> <p>Komisioni i Vlerësimit pasi shqyrton kandidaturat i propozon Dekanit për miratim kandidatët e përzgjedhur, sipas një renditje të kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës. (Evidencë R2)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

				X
--	--	--	--	---

## Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Ky department bashkërendon dhe administron veprimtaritë akademike, veprimtaritë kërkimore shkencore në respekt të lirisë akademike të stafit mësimdhënës. Numri total i anëtarëve të Departamentit është 10 pedagogë. Nga vëzhgimet që bëri grupi i ekspertëve u vu re që mësimi zhvillohej në një godinë me kushte shumë të mira dhe bashkëkohore, e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme si: kompjuter, internet, fotokopje, videoprojektor në cdo sallë, e gjitha e vendosur në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. Institucioni i siguron stafit, pa pagesë, akses në bibliotekën online për t'u ardhur në ndihmë në punën e tyre kërkimore.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni mundëson cdo vit organizimin e një konference ku stafi akademik ka mundësi të prezantojë pjesë nga projektet dhe studimet që ka, si dhe u mundësohet publikimi i artikujve e studimeve shkencorë në revistën shkencore "Optime". Ndërkohë sipas intervistave që u zhvilluan me grupe të ndryshme u pa që institucioni ishte i gatshëm të mbështeste stafin edhe në projekte të tjera brenda ose jashtë vendit me financime modeste. Gjatë këtij viti duket që situata e pandemisë i ka penguar disi në organizimet e përbashkëta, por pavarësisht kësaj ata kanë krijuar konferenca online përmes platformave të ndryshme. Një konferencë presin ta zhvillojnë në muajin shkurt në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Universiteti u mundëson stafit akademik kualifikime mbi trajnime të ndryshme për aplikimin e metodave inovative në mësimdhënie, gjë e cila dëshkohet në dokumentacion por edhe në intervista me stafin. Referuar RVB-së, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me njësitet e tjera të institucionit organizon trajnime të stafit me fokus specifik për të përmirësuar zhvillimin profesional. (Evidencë nr.III.5.a.b)
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të	AU ka angazhim optimal të stafit akademik e administrativ për të siguruar përmbushjen e objektivave të programit të studimit "Bachelor" në "Psikologji". Për ofrimin e këtij programi janë të punësuar, me kohë të plotë: 1 Profesor i asociuar, 7 Doktor të shkencave 2 me Dr. proc dhe 1 Asistent Lektor Master i Shkencave.

*Buy* *EW*

programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Vlen që të theksohet se jo të gjithë kanë formimet bazë në psikologji dhe gjithashtu stafi akademik i ftuar dhe i brendshëm kanë levizje të shpeshta.</p> <p>Nga grupi i ekspertëve u vu re që departamenti ka nevojë për të rritur numrin e personelit akademik me formim bazë në psikologji, qoftë ky me kohë të plotë apo të pjesshme, duke respektuar kriteret e Ligjit të Arsimit të Lartë. Programi bazë Bachelor në Psikologji ka nevojë për një numër më të madh ekspertësh në fushë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Zhvillimi i mësimin në programin e studimit Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” realizohet në godinën qendrore të “Albanian University”, me salla dhe klasa në funksion të procesit mësimor, salla të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike si kompjuter, video projektor, ekrane të mëdha, flipcharte, multimedia, hapësirë kjo e mjaftueshme për numrin e studentëve që studiojnë në këtë degë. Klasat kanë tavolina të lëvizshme që mund të përdoren edhe për improvizime të seancave psikologjike, focus gupe apo punë në grupe për studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se mjediset dhe ambjentet ishin të mjaftueshme dhe në përputhje me të gjitha kërkesat për një mësimdhënie optimale, duke respektuar kështu edhe hapësirat për cdo student.  Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të	Grupi i ekspertëve vizitoi ambjentet ku zhvilloheshin orët e leksionit dhe seminarit, laboratorin e kompjuterave, bibliotekën, zyrat dhe mjediset e tjera të administratës dhe sekretarisë. Cdo mjedis ofronte kushte të përshtatshme për aktivitetin përse përdorej.

moduleve, aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Institucioni ka një laborator të teknologjisë së informacionit i cili është i pajisur me softëtarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire programit mësimor.  Laboratori ka mundësi që t'ju shërbejë disa programeve të studimit, sipas një skedulimi normal të orarit të punës. Një punonjës i IT është gjithnjë në dispozicion të mirëmbajtjes së laboreve dhe rrjetit kompjuterik të AU gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore. Kjo gjë u konstatua gjatë vizitës dhe intervistave të zhvilluara nga GVJ.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Praktika mësimore në programin Bachelor zhvillohet në vitin e fundit akademik. Departamenti kishte caktuar koordinatore për praktikën që ndiqnin studentët gjatë gjithë vitit. Nga dokumentacioni i dorëzuar janë listuar një sërë marrëveshje me institucione të ndryshme. Nga intervista me pedagogët, praktika shihej si një pikë e fortë e programit, por gjatë periudhës së pandemisë nuk është zhvilluar dot në kushtet që ata donin. Nga departamenti ishin caktuar dy pedagogë që ndiqnin praktikën e studentëve gjatë vitit të fundit të studimit. Pjesa më e madhe është organizuar online me detyra dhe minidetyra. Pavarësisht kësaj, në tërësi bashkëpunimi me institucionet ishte i konsoliduar dhe strukturuar sic duhej.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve ambjentet e bibliotekës si dhe aksesin në bibliotekë online ku secili mund të aksesojë libra sipas fushave përkatëse. Të gjithë kishin akses të kërkonin libra dhe artikuj shkencor në adresën e tyre online, si dhe të punonin pranë ambjenteve të bibliotekës sa herë të dëshironin.

*Signature*



	<p>Referuar RVB dhe informacionit të marrë nga punonjësja e bibliotekës, konstatohet që në bibliotekën e godinës qendrore janë rreth 172 tituj të disponueshëm për pedagogët dhe studentët, që janë në ndihmë të programeve të ofruara nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme (<i>Evidencë nr.III.7</i>).</p> <p>Nga punonjësja e bibliotekës u raportuan rreth 83000 libra në fushën e psikologjisë online.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe të huaj. Disa nga librat që janë në përdorim të departamentit të psikologjisë janë përkthyer dhe botuar pranë UFO Press. Ndërkohë që ka edhe libra të tjera të pedagogëve që janë botuar në shtëpi të tjera botuese. Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave.</p> <p>Revista Periodike Shkencore “Optime” mbledh punime nga departamente të ndryshme dhe del në varësi të kohës dhe prurjeve që ata kanë. Është një revistë e konsoliduar dhe me traditë, që ka disa vite që përfaqëson institucionin me botimet e stafit të brendshëm dhe të jashtëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka mundur abonim vjetor në bibliotekën online “QUESTIA, që ndikon në realizimin me sukses të programit të studimit, të projekteve kërkimore shkencore dhe për përgatitjen e tezës së diplomës. Listohen rreth 83000 libra në fushën e psikologjisë referuar konfirmimit edhe gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion të grupit të ekspertëve, u vu re që biblioteka ishte e pajisur me laptop të cilët kishin të instaluar të gjitha programet kompjuterike të nevojshme</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Nga vëzhgimet e kryera si dhe intervistat me student e pedagog, u vu re që të dyja palët ishin të kënaqur me aksesin në bibliotekën online dhe nuk kishin problem në gjetjen e informacionit. Drejtuesja e departamentit dhe dekania e komanduar së fundi në detyrë, thanë që një ndër rekomandimet e grupit të mëparshëm të akreditimit lidhej pikërisht me mundësinë e regjistrimit në një bibliotekë online, gjë e cila ishte përmbushur më së miri. Grupi ekspertëve pati akses për të hyrë vetë në bibliotekën online gjatë vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që</p>	<p>Oraret e shërbimit të bibliotekës pëputhen me orarin e mësimit të ciklit të parë bachelor. Në rregulloren e bibliotekës thuhet që ajo</p>

*Suy* *GLB*

janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p>është në dispozicion të studentëve nga dita e hënë deri të premte nga ora 8.00 deri 16.00.</p> <p>Orari është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Punonjësja e bibliotekës citoi por edhe në raport thuhet se biblioteka ka orarin e shërbimeve ekstra edhe në përputhje me oraret mësimore të studentëve për sezone të veçanta si ato të provimeve dhe riprovimeve. Pra nëse studentët kërkonin të shkonin në bibliotekë përtej orarit të vendosur, mund të kërkonin në bashkëpunim me departamentit orar shtesë. Kjo kryesisht për periudhat më intensive të vitit sic janë përgatitja e detyrave apo punimeve dhe zhvillimi provimeve. Për çdo student ka kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion sekretaria mësimore e programit të studimit dhe kryesekretaria e fakultetit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Gjatë vëzhgimit në institucion u panë dokumentet përkatëse dhe u kontrolluan regjistrat për secilin vit si dhe regjistri themeltar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.</p> <p>Sekretaria mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, i ç' regjistruar si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre. Të gjitha procedurat janë konform cdo rregulli. GVJ konstatoi se sekretaria ishte shumë e rregullt në mbajtjen dhe dokumentimin e cdo të dhëne lidhur me studentët. Këta të fundit kishin dosjen individuale. Nga ekspertët u kërkuan në mënyrë rastësore disa dosje dhe u shqyrtuan të gjitha procedurat. Ato rezultuan sipas rregullave në fuqi.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit	Dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Pranë kësaj zyre gjendej i gjithë informacioni për personelin akademik, ndihmës, administrativ etj. Dosjet e tyre ishin të organizuara mjaft mirë. Punonjësja e kësaj zyre dokumenton në

administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	mënyrë korrekte cdo të dhënë dhe shfaq angazhim maksimal për të skeduar cdo informacion. Ajo ka të gjitha kontratat dhe aneks kontratat për stafin akademik. (Evidencë RI.c.d.e)			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Aksesi në informacion dhe dokumentacion për personelin dhe studentët bëhet në përputhje me ligjin e ruajtjes së privatësisë si dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga sistemi i brendshëm i institucionit. Studentët dhe stafi akademik aksesojnë përmes platformës Microsoft teams nëpërmjet një username dhe fjalëkalimi që iu vihet në dispozicion nga administrata e universitetit (sekretari dhe IT). Kjo platformë u kishte ardhur në ndihmë gjatë kohës së pandemisë dhe mësimi online si një mënyrë për të shkëmbyer leksione dhe material të ndryshme, për të zhvilluar orët e leksione dhe seminarit apo dhe aktivitete të tjera të përbashkëta.			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Personeli akademik shkëmben informacion me studentët me anë të emaileve individuale dhe platformës online që aksesohet lehtësisht me adresat e dhëna nga universiteti. Në këtë platformë pedagogët ngarkojnë leksione dhe material për studentët. Këta të fundit mund të shohin vlerësimet e tyre si dhe të ankohen nëse nuk janë dakord. Gjatë mësimi online kjo platformë (Teams) dhe Exam.net ishte përdorur maksimalisht.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Raportimi i aktiviteteve mundësohet në kohë reale përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Të gjitha grupet e përfshira në intervistat e zhvilluara u shprehën që ky portal ishte mjaft funksional për ta.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Bazuar në të dhënat e pasqyruar në RVB dhe vizitës në institucion, konstatohet që të gjitha të dhënat mbi Departamentin si dhe programet që ky departament ofron janë të publikuara në faqen zyrtare të “Albanian University” ( <a href="http://www.albanianuniversity.edu.al">www.albanianuniversity.edu.al</a> ) Aty jepet një informacion i detajuar lidhur me programet e studimit, stafin akademik, konferenca dhe trajnime që organizon departamenti etj. Informacioni në faqen zyrtare të “Albanian University” është i aksesueshëm në dy gjuhë shqip dhe anglisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.6

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar RVB-së, Albanian University harton pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit. Raportet financiare dorëzohen në Degën rajonale të Tatim Taksave çdo fund muaji.</p> <p>Para fillimit të vitit të ri akademik, Bordi i Administrimit vendos kriteret mbi të cilat do hartohet projektbuxheti vjetor dhe rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij dhe ia përcjell organeve drejtuese akademike dhe administrative.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i raportit financiar paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literatures, si edhe aksesin në bibliotekat on-line.</p> <p>Në kontratat e punës së stafit akademik me kohë të plotë caktohet edhe paga mujore që merr secili prej tyre, kjo referuar edhe dokumentacionit që na mundësoi zyra e burimeve njerëzore.</p> <p>Burimet financiare të institucionit hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe shkencore të AU, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Përsëri në raportin financiar shohim gjendjen financiare dhe shpërndarjen e burimeve financiare. Albanian University harton raportet dhe pasqyrat financiare, të kërkuara nga ligji dhe i është nënshtruar kontrollit të Degës së Tatim Taksave.</p> <p>Referuar RVB-së në Albanian University është ngritur dhe funksionon si njësi administrative Zyra e Auditit të Brendshëm. Kjo Zyrë, si pjesë integrale e kontrollit të brendshëm dhe njësi e specializuar e saj, ka për mision kontrollin e proceduarve dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së financës dhe auditit të brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare</p>	<p>Referuar dokumentacionit dhe RVB konstatojmë se institucioni ka të dokumentuara raportet financiare për të tri vitet e fundit, procedurat e të cilave fillojnë të kryen gjatë periudhës Mars – Maj.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Nga raportet financiare të dorëzuara duket qartë që institucioni dëshmon qëndrueshmëri dhe kapacitete të mjaftueshme për sigurimin e veprimtarisë së universitetit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

*Duy* *gub*

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Procedurat e pranimit të studentëve bëhen në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kriteret e studenteve miratohen nga Senati Akademik. Numri i studentëve si dhe shpërndarja e tyre bëhet sipas zërave në tabelën e percaktimit të kuotave të pranimit (studentë për program të dytë studimi, transferime, të huaj.), referuar dokumentacionit që është dorëzuar si dhe konfirmimit nga stafi gjatë vizitës së grupit të ekspertëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për të gjithë studentët zbatohen ligjet dhe rregullat në fuqi për regjistrim dhe frekuentim të vitit akademik. Kandidatët zgjedhin programin e studimit që duan të regjistrohen në “Albanian University” duke plotësuar Formualin e Aplikimit në Portalin e Maturës Shtetërore të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) (<a href="https://ualbania.al/">https://ualbania.al/</a>), cituar kjo në RVB dhe konstatuar edhe gjatë vizitës në institucion me punonjësit e sekretarisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit pranë “Zyrës së regjistrimeve dhe transferimeve” mbi organizimin e programit të studimit. Kriteret për procedurat e pranimit si: nota mesatare e gjimnazit mbi 7.5, kriteret e transferimit dhe njohjes së studimeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe publikohen në faqen zyrtare. Në syllabuset e lëndëve studentët njihen me format dhe kriteret e vlerësimit që në fillim të semestrit. Informacioni është i qartë dhe transparent për të gjithë.</p> <p>Sistemi i pikëzimit është i unifikuar për të gjithë programin ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>60% i zë provimi final;</li> <li>20% ai i ndërmjetëm;</li> <li>10% detyra e kursit;</li> <li>10% puna në klasë;</li> </ul> <p>Në fillim të vitit akademik “Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve ne bashkëpunim me “Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme” organizon një javë orientuese kryesisht për studentët që janë për herë të parë të përfshirë në program. Gjatë orëve të hapura ata njihen me të gjithë</p>

	komponentët e programit duke nsiur që nga licensimi, kurrikula, akreditimi etj. (Evidencë nr V. 1)			
	Ndërkohë institucioni ka edhe “Zyrën e karrierës dhe Alumnit” (Evidencë nr V.2) e cila ndihmon studentët për tu orientuar brenda institucionit por edhe lidhjet me tregun e punës. Kjo zyrë ka prodhuar Udhëzuesin për Zhvillimin e Karrierës e cila u jepet cdo student dhe trajnohen në një orë të hapur sidomos në vitin e fundit të bachelorit. (Evidencë nr. V.3)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Senati Akademik miraton përpara çdo viti akademik kriteret e vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve, në përputhje me rregulloren e universitetit.  Ajo që u konstatua edhe nga GVJ lidhej me faktin që të gjitha kriteret e pranimit të studentëve publikohen në faqen zyrtare të “Albanian University” si dhe në të gjitha rrjetet sociale që menaxhon institucioni. Këto kriteret janë konform ligjeve në fuqi.			
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015, vendimit të këshillit të ministrave për vendosjen e notës mesatare dhe rregullat e maturës shtetërore. Këtu parashikohen dhe studentë të huaj që kanë mbrojtur gjuhën shqipe.  Programi i studimit ka të përcaktuar kriteret e pranimit: - 70% mesatarja sipas VKM; - 30% mesatarja e lëndëve të cilat përcaktohen çdo fillim viti me Vendim të Senatit Akademik të AU, pas kërkesës së MASR-së			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni në cdo vit bën ditët e hapura dhe informom publikun me të gjithë elementët e programit të studimit. Ata përdorin kryesisht edhe rrjetet sociale, madje gjatë periudhës së pandemisë kanë zhvilluar orë të hapura leksioni online me pedagog të ftuar nga vendi por jo vetëm.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga intervistat e zhvilluara me studentët dhe stafin akademik si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, doli në pah fakti që studentët janë të informuar lidhur me vlerësimin e tyre. Kjo realizohet kryesisht nëpërmjet platformës për shkak të situatës së pandemisë, por edhe nga kontakti i afërt që ata kanë me sekretarinë, duke qenë se numri i tyre është relativisht i vogël.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Sekretaria mësimore informon studentët mbi kriteret e procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme. Ashtu si cdo institucion tjetër arsimor, edhe Albanian University mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të parë, në programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private apo publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në institucione të tjera të arsimit të lartë. Kjo është një procedurë e hapur dhe pa pengesa. Gjatë vizitës në institucion u konstatua dhe konfirmua edhe njëherë ajo që është shkruar nga vetë grupi vlerësimit të brendshëm. Albanian University është e hapur për mobilitetin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në Syllabusin e cdo lënde/moduli përpos përshkrimit, objektivave të modulit, rezultatet e të nxënit, metodika e mësimdhënies dhe detyrimet e studentit, është parashtruar dhe vlerësimi i studentit. Lektor i përgjegjës i lëndës/ modulit njeh studentët me kriteret e lëndës dhe vlerësimin e tyre. Sistemi i pikëzimit është i unifikuar për të gjithë programin bachelor në psikologji, ku 60% i zë provimi final, 20% ai i ndërmjetëm, 10% detyra e kursit dhe 10% puna në klasë. Nga biseda me ta dukej qartë që ky informacion nuk u mungonte.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë informon studentët lidhur me kriteret e procedurat e punimit të diplomës/provimit përfundimtar të formimit për diplomimin në programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji” nëpërmjet takimeve peridoike që zhvillon.</p> <p>Nga takimi me studentët rezultoi se studentët në këtë program zgjidhnin kryesisht provim final dhe jo punim diplome.</p> <p>Më konkretisht, një sqarim më i hollësishëm rreth procedurave të diplomimit studentëve u bëhet në vitin e tretë, i cili është edhe viti i mbylljes së studimeve të tyre. Departamenti vendos në dispozicion të studentëve rregulloren e diplomimit si dhe udhëzuesin e diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm</p>	<p>Kjo realizohej cdo vit përmes formave të ndryshme si: njoftimet në faqen zyrtare të web, njoftimet në rrjetet sociale, njoftimet e informacionet e vendosura në stendat e universitetit.</p>



dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni organizon me studentët, stafin akademik dhe administrativ, që në javën e parë të fillimit të vitit akademik një javë orientuese. Sic është cituar më sipër në raport, gjatë kësaj jave studentët marrin informacion lidhur me licensimin e programit, kurrikulën, akreditimin, mbi objektivat e programit të studimit, arrijtet në fund të tij dhe hollësi të tjera në lidhje me programin e studimit. Gjatë këtij viti situata e pandemisë dukej që e ka penguar disi këtë proces, megjithatë informimi nuk ka munguar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen vazhdimisht sa i takon detajeve lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve. Informimi fillon në javën e parë orientuese, vijon me njoftimet e ndryshme që bëjnë sekretariatë mësimore përgjatë procesit mësimor.  GVJ konstatoi gjatë intervistave që kjo gjë mundësohej shpeshherë edhe në rrjetet sociale të universitetit. Në faqen zyrtare mund të gjesh të dhëna mbi fakultetet, departamentet, programet e studimit, kurrikulën e me gjerë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në intervistat e zhvilluara dhe shqyrtimin e dokumentacionit, shohim që vlerësimi është transparent.  Zyra e koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve vë në dispozicion të tyre materiale dhe broshura informuese ku ata njihen më gjerësisht për të drejtat dhe detyrimet e tyre.  Provimet sekretohen me rregullsi maksimale nga sekretaria dhe studentët janë të hapur për të parë dhe kontrolluar tezën e tyre. Sekretaria mësimore i informon studentët për rezultatet e tyre si për lëndë të caktuara, ashtu edhe për të gjitha lëndët ku studenti është vlerësuar në përfundim të semestrit ose vitit akademik, në rastet kur ky i fundit nuk ka qenë prezent për të marrë notën.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	GVJ takoi përfaqesueset e dy zyrave që janë prezente pranë “Albanian University”, përkatësisht: “Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve” e cila i mbështet studentët për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë cikleve të studimit dhe

*Duy Gelo*

<p>institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>“Zyra e Karrierës dhe Alumnit” që siguron lidhjet për studentët, komunitetin e gjerë universitar dhe botën e punës. Nga intervista që u zhvillua me punonjësen u pa një mungesë informacioni lidhur me këshillimin e karrierës.</p> <p><i>Për këtë arsye GVI rekomandon trajnime të vazhdueshme brenda fushës si kualifikime më të thelluara në këtë drejtim.</i> Përfaqësuesja e kësaj zyre përpiquej të ndiqte udhëzimet por nuk kishte shumë informacion mbi hapat konkret lidhur me procesin e karrierës.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Duke u referuar në RVB, shohim që studentët janë vazhdimisht të informuar lidhur me cdo të rë që ndodh brenda programit të tyre të studimit. Kjo u evidentua edhe në intervistën e zhvilluar me ta, ku dukej qartë niveli i kënaqësisë në këtë drejtim. Ata janë në kontakt të vazhdueshëm me pedagogët e tyre por edhe me përfaqësues nga institucioni.</p> <p>Ata u shprehën që marrëdhëniet me stafin akademik dhe joakademik ishin relativisht të afërta dhe nuk mungonte asnjë informacion që u nevojitej. Njoftimet publikohen gjithashtu në faqen zyrtare të web, në rrjetet sociale si dhe në standat e universitetit. Informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet platformës aktuale Microsoft Teams.</p> <p>Gjithashtu studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme në distancë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faqes zyrtare të Albanian University (www.albanianuniversity.edu.al)</li> <li>- Njoftime në platformë;</li> <li>- Komunikimi në vijimësi në nivel departamenti;</li> <li>- Njoftimi përmes adresave të email;</li> <li>- Njoftime në rrjetet sociale;</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Nga inspektimi në sekretarinë e universitetit gjatë vizitës në institucion, u pa që ajo disponon statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin “Bachelor” në “Psikologji”. Këto të dhëna ishin në formë elektronike në database-n e sekretarisë mësimore si dhe regjistrave hard-copy. Sekretaria shfaq rregullsi në të gjithë dokumentacionin që mban lidhur me regjistrimet e studentëve që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre. GVJ konstatoi gjithashtu se sekretaria mësimore disponon statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar ndër vite.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të gjitha të dhënat janë pranë sekretarisë të organizuara sipas secilit vit akademik. Në lista figuronin disa student që ishin transferuar nga vite të mëparshme ose i kishin të mbartura disa provime. Secili ishte i pajisur me numër matrikullimi nga MASR. Sekretaria mësimore dispononte gjithashtu të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, largimet para përfundimit të programit dhe mospërfundimit me sukses të vitit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore dispononte të gjitha të dhënat lidhur me ecurinë e studentëve gjatë cdo viti akademik, përfshirë këtu edhe student që ishin larguar, transferuar apo kishin pezulluar vitin akademik.</p> <p>Sipas <i>RVB</i> dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2018-2019 14 studentë gjithsej;  Viti 2019-2020 12 studentë gjithsej;  Viti 2020-2021 6 studentë gjithsej;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në sekretarinë mësimore gjëndeshin të dhënat statistikore të studentëve sipas cdo viti akademik, duke zbatuar ruajtjen e privatësisë. Të interesuarit mund të marrin informacion në cdo moment që u nevojitet. Këto të dhëna mbaheshin për një periudhë 4 – 5 vjecare edhe nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Nga intervista më përfaqësues të departamentit dhe grupeve të ndryshme të punës, u vu re që pjesa mbizotëruese e studentëve që mbaronin ciklin e parë, vazhdonin studimet në ciklin e dytë. Zyra e karrierës mbante të dhëna mbi ecurinë dhe punësimin e tyre më pas për disa vite me radhë, sipas specialistet që punonte aty. <i>Vlen për tu theksuar sërish që ky sektor kishte nevojë për përmirësim dhe trajnime të vazhdueshme. Zonja që punonte aty</i></p>

	<i>nuk ishte e fushës dhe nuk kishte trajnimin e duhur. Institucioni ka nevojë për një këshillues karriere të mirë formuar për punën që duhet të bëjë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Studentët përfaqësohen në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit siç janë: Senati Akademik, komisionet si dhe grupe pune duke dhënë kontributin e tyre. Gjatë intervistës që u zhvillua në institucion nga GVJ, ishte e pranishme edhe një studente si përfaqësuese e tyre.</p> <p>Edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm ishte në grupin e punës një studente. Disa nga studentët e ekselencës ishin punësuar në institucion si pjesë e administratës ose staf akademik. Një ish student ishte punësuar vitet e fundit pranë zyrës së rektorit të universitetit. Ajo u takua nga grupi ekspertëve dhe shprehu konsideratë për institucionin dhe mundësinë e punësimit. Edhe disa nga pedagogët e pranishëm vinin nga radhët e studentëve të ekselencës që kishin studiuar në Albanian University.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në RVB, dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistave të zhvilluara me stafin e institucionit, universiteti garanton se përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, është reale dhe konkrete. Studentët ishin pjesë e disa komisioneve ku japin kontributin e tyre.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave	Në dokumentacionin e shqyrtuar, duket që Departamenti i Psikologjisë ka në vëmendje ngarkesën e studentëve e cila ka një shpërndarje optimale (leksione, seminare, ushtrime e laboratorë) orë mësimi në javë, në përputhje me udhëzimet nga MASR. Sipas drejtueses së departamentit, kurrikula ka patur disa ndryshime shumë të vogla (më pak se 20%) që nga akreditimi i fundit. Grupi

*Buy ELO*

<p>joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>i ekspertëve rekomandoi përmirësim të disa lëndëve me zgjedhje të cilat ishin në kurrikul por që nuk ishin zgjedhur asnjëherë. Për këtë arsye u rekomandua të zëvendësoheshin me lëndë më të përshtatshme, si dhe riorganizim të personelit akademik që jep secilën lëndë, kryesisht ato të karakterik klinik.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Ky proces ende nuk ishte zhvilluar pas akreditimit të fundit që kishte patur institucioni dhe departamenti. Edhe gjatë intervistave të zhvilluara nga vlerësuesit, <b><i>nuk doli në pah fakti që studentët janë të pranishëm në procesin e ndryshimeve në kurrikul.</i></b> Ndërkohë në raportin e vlerësimit të brendshëm thuhet që nga akreditimi i fundit u rekomandua hapja e një klinike pranë departamentit për të mundësuar më shumë orë në praktikë. Nga intervista me drejtuesen e departamentit kjo klinikë nuk ka qenë shumë funksionale, edhe pse është bërë një përpjekje për ta atashuar në të njëjtat ambjente.</p> <p><i>Nga të gjitha vlerësimet dhe vëzhgimet e bëra, rekomandojmë që kjo klinikë të riorganizojë qëllimin dhe fokusin e saj, pasi nuk duket se ka qenë shumë funksionale. Ajo duhet të atashohet pranë zyrës së karrierës për të ndihmuar orientimin dhe këshillimin e studentëve.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në rregullore dhe asaj që dëshmuar vetë studentët, GVJ konstatoi që procesi i vlerësimit të tyre ishte transparent dhe nuk kishte patur probleme. Studenti kishte të drejtën e ankimimit të rezultatit. Ankesa i paraqitej me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda tre ditëve nga marrja e rezultatit të provimit. Nuk kishte raste precedente pasi ata viheshin në kontakt relativisht të afërt me pedagogët, duke qenë të paktë në numër. Marrëdhëniet mes tyre ishin shumë të mira dhe pedagogët ishin të hapur me ta.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit

Institucioni ka krijuar strukturën e zyrës së regjistrimeve dhe ekuivalentimeve, e cila u siguron studentëve mbështetjen, burimet

<p>të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet.</p> <p>Studentët mund të informohen në faqen zyrtare të universitetit ku pasqyrohen të gjitha aktivitetet. Kjo faqe përditësohet me informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta. Punonjësit thonë në intervistën e zhvilluar që një rol të rëndësishëm në informim luan edhe zyra e karrierës. Ky fakt u konfirmua edhe gjatë intervistës me përfaqësuesen e kësaj zyre.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në vlerësimin e brendshëm, citohet që stafi akademik, sekretaria mësimore, Specialistja e Këshillimit të Karrierës mbajnë lidhje për procesin mësimor, mungesat apo vlerësimin me studentët. Studentët pajisen me broshura dhe materiale të ndryshme të cilat u vijnë në ndihmë për informim dhe orientim lidhur me procesin mësimor apo programin e studimit.</p> <p>Në RVB thuhet gjithashtu se Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve është përgjegjëse për krijimin e programit të mentorimit në mënyrë që të mbështesë profesionalisht studentët dhe ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sipas RVB dhe intervistave të zhvilluara nga grupi i ekspertëve u evidentua që Zyra e karrierës synonte informimin dhe këshillimin e studentëve. Studentët informoheshin lidhur me kurrikulën e universitetit, mundësitë e punësimit dhe praktikës, shkrimin e cv dhe letrës së motivimit etj.</p> <p>Ndërkohë Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndihmonte studentët në përzgjedhjen e institucionit ku ata do të kryenin praktikën mësimore. Mentori i studentëve caktohej nga njësia bazë dhe mbikqyrte studentët gjatë realizimit të praktikës profesionale. Nga departamenti ishin caktuar dy mentor që ndiqnin praktiken e studentëve gjatë vitit të fundit të studimeve. kjo praktike zhvillohej në institucione të ndryshme pasi kishte si qëllim njohjen e studentëve me profile të ndryshme të punës së psikologut. Gjatë periudhës së pandemisë studentët kishin zhvilluar edhe detyra apo miniprojekte pasi nuk kishin mundur të realizonin 100% praktikën në terren.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe</p>	<p>Zyra e karrierës ka të dhënat për ecurinë e studentëve edhe pas diplomimit. Ata mbajnë të dhënat e studentëve si numër telefoni dhe adresë emaili. Në këtë mënyrë vihen në kontakt me studentët. Ky informacion jepet nga zyra e karrierës dhe drejtuesit e institucionit, por grupi vlerësuesve nuk pati mundësi të takonte studentë të kësaj kategorie, me përjashtim të disa rasteve të punësuar në institucion.</p>

organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përdor një sërë metodash sasiore dhe cilësore për të matur dhe vlerësuar ecurinë e programit të studimit. Kjo bëhet në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri. Ajo garanton zbatimin e procedurave të aprovuara nga organet drejtuese nëpërmjet kontrollit dhe vlerësimit të procesit mësimor. Studentët plotësojnë pyetësor lidhur me kënaqësinë për secilën lëndë dhe problematikat që mund të kenë. Më pas të dhënat e grumbulluara analizohen dhe dokumentohen pranë njësisë bazë. Në raste të vecanta kur ka problematika, i komunikohet personalisht pedagogut nga drejtuesi i departamentit dhe diskutohet ecuria e mëtejshme. I gjithë ky informacion u konstatua gjatë intervistave të zhvilluar me përfaqësues të zyrës dhe personel akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni e ka të ngritur një organ të tillë dhe funksionon rregullisht që prej vitit 2009. (Evidencë nr. VI. 1) Përmes NJSBC universiteti synon një mbarëvajtje optimale të procesit të mësimnxënies dhe pasqyron të gjitha kërkesat që kanë studentët. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit, ajo organizon punën në bashkëpunim me njësitë bazë, për kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në RVB citohet gjithashtu që në mbështetje të cilësisë në AU funksionon edhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë që në shtator të vitit 2016, ngritur me Vendim Senati Akademik

*Buy* *Edu*

	Nr. 157/3 dt. 08/09/2016, anëtarët e të cilëve përditësohen çdo vit (Evidencë nr. VI.3).			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<p>Nga intervistat e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se institucioni përdor metoda të ndryshme për të matur cilësinë si:</p> <p>Pyetësorë anonim të studentëve në përfundim të semestrave (2 herë në vit akademik);</p> <p>Fokus grupe me studentë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme;</p> <p>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet;</p> <p>Vëzhgime gjatë kryerjes së mësimit ose praktikave mësimore;</p> <p>Në RVB citohet gjithashtu se në fillim të vitit akademik por edhe gjatë tij, realizohen trajnime me personelin akademik, në disa raste edhe me lektorë të huaj, për çështje të tilla që lidhen me teknologjitë e mësimdhënies, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, etj. (Evidencë Nr.III.5).</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton një raport semestral dhe një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, stafin akademik të rekrutuar, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore etj. (Evidencë nr VI. 4)</p> <p>NJSBC pas analizës vjetore përpilon politika dhe procedura të caktuara për të përmirësuar programe të studimit. Këto sugjerime iu shkojnë departamenteve përmes komisioneve ad hoc të sigurimit të cilësisë, të cilët aktivizojnë stafin akademik për të bërë përmirësimet përkatëse.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## Standardi VI.2

*Buy ELL*



**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, përmes Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bën një vlerësim periodik të cilësisë (çdo fund semestri dhe në fundvit) si dhe përdor procedura të caktuara. Përmes Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti, NJSBC siguron shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të procesit të përmirësimit të programeve të studimit. NJSBC deklaron se bën trajnime të vazhdueshme për stafin e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të cilësisë (anëtarët e komisioneve në nivel departamenti) si edhe për anëtarë të tjerë të stafit. Edhe lidhur me përshtatjen me platformat online, stafi akademik është trajnuar dhe ka marrë asistencën e nevojshme.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka hartuar dhe vënë në përdorim mekanizma dhe instrumenta për mbikëqyrjen e ecurisë së programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji e Përgjithshme”. Ndër to mund të përmendim pyetësor për studentët, për personelin akademik, vëzhgime në auditor etj.</p> <p>Referuar RVB-së cdo fillim viti nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Departamenti në bashkëpunim me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti, angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve në përputhje me të rejtat më të fundit në lëndën përkatëse. Kjo gjë u konstatua edhe nga intervistat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin</p>	<p>Pas administrimit të pyetësorëve dhe instrumentëve të tjerë matës, njësia analizon të dhënat dhe i raporton ato tek strukturat përkatëse. Në rastin kur shfaqen pakënaqësi nga studentët lidhur me stafin akademik apo administrativ, ndiqen procedura të posaçme. Sipas punonjësve nuk kanë patur probleme specifike nga shqetësime të ardhura nga studentët. Në raste minimale i kanë administruar dhe zgjidhur në rrugë joformale. Kjo duke patur kontakte të drejtpërdrejta me lektorin dhe drejtuesin e njësisë bazë.</p> <p>Në RVB dhe dokumentacionin që është bashkangjitur thuhet që Albanian University për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta si më poshtë:</p> <p><i>Të tërthorta:</i></p>



e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>- Raport vetëvlerësimi për programin e studimit (<i>Evidencë nr.VI.7</i>)</p> <p>- Raportet të vetëvlerësimit (2 herë në vit, në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik) (<i>Evidencë nr. III.6</i>)</p> <p>- Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit) (<i>Evidencë nr.III.1</i>)</p> <p>- Fokus grupe (në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. (<i>Evidencë nr. III.2</i>)</p> <p>- Raporte vetëvlerësimi të pedagogëve (<i>Evidencë nr. III.6</i>)</p> <p><i>Të drejtpërdrejta:</i></p> <p>- Hartohen teste paraprake dhe përfundimtare;</p> <p>- Bëhen vëzhgime gjate kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve ;</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i brendshëm i programit kryhen në mënyrë periodike nga Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë. Kjo e fundit raporton rezultatet të cilat shërbejnë si dokument bazë për cdo akreditim apo kontroll periodik. Edhe gjatë këtij procesi është kryer raporti vlerësimit të brendshëm nga një grup i ngritur nga departamenti i përbërë nga pedagog dhe një student. Grupi vlerësimit të brendshëm u takua edhe gjatë vizitës në institucion nga GVJ, ku u diskutuan çështje të ndryshme të paraqitura në raport.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni përdor metoda vlerësimi përmes instrumenteve të ndryshme për matjen e performances akademike. Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet pyetësorëve të përgatitur, studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe vlerësimin e lëndës, si edhe opinione për lëndën e dhënë nga pedagogu përkatës. Pyetësori i studentëve dhe fokus grupet janë të hartuara

	në mënyrë të tillë ku bëjnë të mundur matjen dhe vlerësimin e të gjithë komponentëve të programit të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>Nga intervistat e zhvilluara dhe shqyrtimi dokumentacionit përkatës, disa nga metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rezultatet e studentëve nëpërmjet testimeve të pjeshme dhe testeve përfundimtare;</li> <li>- Rishikim i vazhdueshëm i programeve mësimore;</li> <li>- Rishikim i kurrikulave;</li> <li>- Vlerësime duke dëgjuar prezantimet e tyre në auditor, në rastin më të fundit përmes platformave online;</li> <li>- Rezultatet e arritura nga punë të ndryshme individuale ose në grup, detyra kursi, projekte etj;</li> <li>- Vëzhgimet gjatë kryerjes së ushtrimeve /praktikës;</li> </ul>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>GVJ nga vizita në institucion dhe intervistat e zhvilluara me të gjitha grupet, konstatoi që universiteti bazohet kryesisht në pyetësor, intervista dhe vëzhgime të drejtpërdrejta në procesin e vlerësimit. Bazuar në RVB thuhet gjithashtu se Albanian University në vitin akademik 2018-2019 ka realizuar për herë të parë edhe një pyetësor me personelin akademik për të marrë përshtypjet e tyre në lidhje me atë çfarë i ofron Institucioni dhe sa të kënaqur janë ato.</p> <p>Në pyetësorët dhe intervistat e zhvilluara kanë patur kryesisht pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës, komunikimin student – pedagog, infrastukturën mësimore, vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të mësuarit etj.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përpiqej të shfaqte angazhimin e tij maksimal me të gjithë aktorët për të ruajtur cilësi të lartë në mësimdhënie, kërkimin shkencor si dhe të shërbimeve të tjera. Brenda tij ishin ngritur grupe të ndryshme pune me qëllim dhe fokus të vecantë duke synuar cilësinë në tërësi të programeve. Institucioni ka vendosur gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi ku fiton dhe ekspertët të jashtëm. (<i>Evidencë I.7</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Duke qënë një departament jo shumë i madh, pothuajse të gjithë anëtarët e personelit akademik ishin të përfshirë në grupe të ndryshme pune. Secili grup mbronte me përpikmëri detyrat dhe përgjegjësitë e tij, gjatë intervistave të zhvilluara me vlerësuesit. Dukej qartë që secili njihte pozicionin e punës që i ishte caktuar. Kjo dukej edhe në grupet e tjera që funksiononin në nivel universiteti.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin bachelor në psikologji, janë angazhuar anëtar të departamentit të psikologjisë. Përkatësisht departamenti i propozon dekanatit koodinatorin dhe grupin e punës për vlerësimin e brendshëm të programit të studimit, i cili përcaktohet me vendim të Rektorit. Në këtë grup ishte angazhuar edhe një studente sipas rregullave dhe procedurave. Vlen të theksojmë që ky grup ka bërë një punë relativisht të mirë për të raportuar të gjithë punën që ka bërë ky departament në disa vite, duke marrë këtu parasysh edhe situatën e pandemisë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Aktorët e brendshëm që janë përfshirë në procesin e vlerësimit të programit janë përpjekur të jenë objektiv në gjykim duke ruajtur integritetin dhe pavarësinë e tyre profesionale. Kjo u identifikua edhe në takimet e zhvilluara me grupin e punës. Këta të fundit kanë sjellë dokumente për të dhëshmuar atë që kanë shkruar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me</p>	<p>Referuar RVB-së një rol të rëndësishëm kanë edhe ekspertët e jashtëm që angazhon institucioni. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe intervistat e zhvilluara nuk u identifikua ndonjë rast specifik ku është dhënë ekspertizë e jashtme.</p>

cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni koordinon veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të cilësisë në nivel insitucional, sipas njësive dhe aktorëve të përfshirë në të.</p> <p>Raportet e saj parqiten për miratim në organet përkatëse dhe gjetjet e tyre përcillen në njësitë kryesore për përvijimin e mëtejshëm të punës. Institucioni gjithashtu përcjell në ministrinë përkatëse Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe e publikon atë në faqen e vet zytare.</p> <p>Sipas përfaqësuesve të NJSBC të gjitha raportet dhe rezultatet e prodhuara nga analiza e pyetësorëve dhe intervistave të zhvilluara me studentët, u bëhen të ditura të gjithë të interesuarve në mbledhje të hapura apo dëgjesa të zhvilluara me ta.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga raportet që janë gjeneruar nga mendimet e dhëna nga studentët dhe stafi akademik, bazuar edhe në rekomandimet e vlerësimit të jashtëm, është synuar përmirësimi dhe ndryshimi i kurrikulës. Sipas drejtueses së departamentit, janë propozuar disa ndryshime të cilat nuk e kanë kaluar masën 20%. Pas përfundimit të procesit të akreditimit ajo synon të ndërmarrë sërish një hap të tillë duke bërë disa ndryshime jo thelbësore bazuar edhe në raport.</p> <p>Plani i punës dhe raportet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë po ashtu japin rekomandime të cilat i paraqiten rektoratit i cili më pas ndërmerr hapa për të trajtuar problematika.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni monitoron dhe mbështet financiarisht dhe me infrastrukturën e nevojshme grupet e vlerësimit të brendshëm dhe kërkesat që ata parashtrajnë për të përmirësuar cilësinë e programit të studimit. Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm dhe asaj që shprehën vetë punonjësit, brenda institucionit ekziston një frymë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	bashkëpunimi dhe koordinimi duke siguruar kështu mbarëvajtjen sa më optimale të programit.			
	Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm informon studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: "Psikologji e Përgjithshme"**

**a. Pika të forta dhe afirmime**

1. Staf i akademik dhe ai administrativ janë në mbështetje të studentëve dhe shumë pranë tyre;
2. Albanian University ofron një bibliotekë online QUESTIA ku studentët mund të aksesojnë shumë libra në fushën e psikologjisë. Kjo bibliotekë është një vlerë e shtuar për institucionin së bashku me ndërmarrjen botuese Albanian University Press, revistën e universitetit "Optime" të cilat kanë botime periodike dhe përmbajnë libra apo revista shkencore;
3. Institucioni ka një bashkëpunim të gjerë me shumë intitucione të tjera akademike dhe joakademike si brenda edhe jashtë vendit. Këto marrëveshje bashkëpunimi synojnë: a) bashkëpunime me natyrë përfitimi dypalësh; b) mbështetje të ndërsjellë të stafeve dhe vetë proceseve të punës së dy institucioneve; c) mbështetje të stafeve për rritje profesionale. Këto marrëveshje priren të vazhdojnë edhe në të ardhmen;
4. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik;
5. Praktika të mira, të ndërmarra nga komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes punës me trajnimet e stafit dhe fokus-grupet me studentët;

**b. Pika të dobëta**

1. Paqëndrueshmëri e stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme të angazhuar në këtë program studimi;
2. Mospërputhje e fushës akademike – kërkimore të stafit akademik me lëndët që lektrojnë, kryesisht lëndët me karakter profesional dhe aplikativ në fushën e psikologjisë;
3. Në programin ekzistues, kurrikula nuk është azhurnuar dhe përshtatur në përputhje me kërkesat e tregut dhe kurrikulat ndërkombëtare;

**Rekomandime:**

1. Institucioni të marrë masa të menjëhershme për garantimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik me kohë të plotë;
2. Institucioni të përpiket që në rekrutimet e reja të stafit akademik të rekrutojw staf me studime vijimisht në psikologji dhe të rishikojë sidomos pedagogët që japin mesim lëndët profesionale me karakter aplikativ;
3. Të përmirësohet kurrikula duke përfshirë lëndë/module që kanë në fokus formim më të përgjithshëm për një program të ciklit të parë dhe të hiqen lëndë që kanë formim shumë specifik dhe që janë më të përshtatshme për programet e ciklit të dytë;
4. Duke u bazuar në faktin që ky është një program “Bachelor” në “Psikologji” ku studentët marrin një informacion të përgjithshëm lidhur me fushën për të cilën studiojnë, struktura e klinikës e atashuar pranë departamentit mund të marrë një fokus më shumë social duke synuar projekte, trajnime dhe bashkëpunime me organizata të tjera;
5. Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e vogël të studentëve të pranuar në një vit akademik, gjë që është vërtetuar nga statistikat e viteve të fundit bazuar në regjistrime;
6. Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e vogël të studentëve të pranuar në një vit akademik, gjë që është vërtetuar nga statistikat e viteve të fundit bazuar në regjistrime;

**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Psychology" in Albanian University.**

**a. Strengths and affirmations**

1. The academic and administrative staff supports the students and is very close to them;
2. Albanian University offers an online library (QUESTIA) where students can access many books in the field of psychology. This library is an added value for the institution together with Albanian University Press, the university’s journal “Optime” which have periodicals and contain books or scientific journals;
3. Albanian University has a wide cooperation with many other academic and non-academic institutions both inside and outside the country. These cooperation agreements aim at: a) cooperation of a mutual benefit nature; b) mutual support of the staff and the work processes of the two institutions; c) staff support for professional growth. These agreements tend to continue in the future;
4. The involvement of student in periodic evaluations for teaching and academic staff;
5. Good practices, undertaken by the internal quality commission through work with staff trainings and focus groups with students;

## b. Weakness

1. Instability of full – time and part – time academic staff which are engaged in this study program;
2. Inconsistency of research field of academic staff with the subjects they teach, mainly the subjects of professional and applied field in psychology;
3. In this program, the curriculum has not been updated and adapted regarded the market demands and international curricula;

## Recommendations

1. The institution should react immediately in order to guarantee the sustainability of full – time academic staff;
2. The institution should try to recruit academic staff with psychological background mostly and in the main time to reconsider only the staffs who teaches subjects with applied character;
3. The institution should improve curricula including courses or modules that focus mostly in general education and remove some specific modules that are more suitable for second cycle program;
4. Based on the fact that this is a bachelor program in psychology where students can take general information regarding the field they are studying for, the structure of the clinic attached to the department should be more social, looking forward projects, trainings and collaborations with organizations;
5. The institution should try to increase the number of the students registered in an academic year, which is confirmed by the statistics of recent years' enrollment;

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	

*Duy*



<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

*Smy* *gub*